

20080070087

**LIGJ
PËR SIGURIM PENSIONAL VULLNETAR
ME FINANCIM KAPITAL**

**KREU 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohet sigurimi pensional vullnetar me financim kapital, themelimi dhe puna e fondeve pensionale vullnetare, shoqërive për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare dhe shoqërive për udhëheqje me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare, si dhe organizimi i skemave pensionale profesionale për të punësuarit e vet nga ana e punëdhënësve dhe për anëtarët e vet nga ana e shoqatave të qytetarëve.

(2) Sigurimi pensional vullnetar me financim kapital, paraqet sigurim pensional në bazë vullnetare të financuar me kapitalizimin e mjeteve. Në këtë sigurim përfshihen personat që nuk janë përfshirë në sigurimin e obligueshëm pensional, dhe personat që janë përfshirë në atë sigurim për realizimin e të hyrave plotësuese.

(3) Në fondet pensionale vullnetare paguhen kontributet vullnetare nga persona, punëdhënës dhe shoqata të qytetarëve që do të zgjedhin për të kontribuar në këtë fonde, mjetet e të cilëve investohen në instrumentet financiare dhe shpërndahen në pajtim me këtë ligj. Shoqëritë për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare dhe shoqëritë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, udhëheqin me këto fonde.

(4) Askush përveç shoqërisë së themeluar në bazë të këtij ligji, nuk mund të kryejë punë të marketingut, as të ofrojë fonde pensionale vullnetare, skema pensionale profesionale ose aranzhmane të ngjashme pensionale, as që në emrin e vet t'i përdorë fjalët “Shoqëri për udhëheqje me fonde vullnetare pensionale”, “Shoqëri për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare”, “Fond pensional vullnetar”, “Skemë pensionale profesionale” ose fjalë të ngjashme, në gjuhën maqedonase ose në gjuhë tjetër.

Neni 2

Parime themelore në të cilat bazohet ligji, janë:

1) **sigurim i mjeteve plotësuese në rast të pleqërisë** – me sigurimin pensional vullnetar me financim kapital, sigurohet kompensimi pensional në vitet e pleqërisë, në pajtim me këtë ligj;

2) **anëtarësim në fondin pensional vullnetar në bazë vullnetare** – anëtar i fondit pensional vullnetar mund të bëhet personi që nuk është përfshirë në sigurimin e obligueshëm pensional, ose personi që është përfshirë në atë sigurim me zgjedhjen e vet;

3) **sigurim pensional vullnetar me financim kapital i bazuar në kontribute të definuara** – në këtë sigurim paraprakisht është definuar shuma e kontributit që paguhet, ndërsa shuma e kompensimit pensional nuk është definuar paraprakisht dhe ajo varet nga kontributet e paguara dhe shtimi i tyre;

4) **sigurim i mjeteve për siguri materiale të personave me kapitalizimin e mjeteve** – kontributet që paguhen në llogaritë individuale të anëtarëve, akumulohen dhe shtohen përmes investimit;

5) **investim i mjeteve në bazë të sigurisë, diversitetit të rrezikut dhe mbajtjes së likuiditetit adekuat** – gjatë investimit të mjeteve të fondeve pensionale, duhet të arrihet siguria dhe të mbahet likuiditeti adekuat i mjeteve, si dhe investimi i tyre në instrumente të ndryshme me rrezik të ndryshëm dhe

6) **transparencë** – anëtarët e fondeve pensionale marrin raporte të rregullta dhe detajore për mjetet e veta, dhe shoqëritë për aktivitetet e tyre rregullisht i njoftojnë opinionin dhe anëtarët e tyre.

Neni 3

Në sigurimin pensional vullnetar me financim kapital, ndalohet çfarëdo diskriminimi i anëtarëve sipas gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, besimit dhe religjionit, përkatësisë politike ose tjetër, prejardhjes nacionale ose sociale, përkatësisë së pakicës nacionale ose etnike, ose në bazë të pasurisë, familjes, gjendjes shëndetësore dhe moshës.

Neni 4

Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë kuptimin si vijojnë:

1. **“Shoqëri për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare”** është shoqëria aksionare, që është e themeluar dhe e autorizuar që të udhëheqë vetëm me fondin pensional vullnetar, në pajtim me këtë ligj.

2. **“Shoqëri për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare”** është shoqëria aksionare, që është e themeluar dhe e autorizuar që të udhëheqë vetëm me fondin pensional të obligueshëm dhe fondin pensional vullnetar, në pajtim me këtë ligj.

3. **“Shoqëri për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme”** është shoqëria aksionare, që është e themeluar dhe e autorizuar që të udhëheqë vetëm me fondin e obligueshëm pensional, në pajtim me Ligjin për sigurim pensional të obligueshëm me financim kapital.

4. **“Shoqëri”** është shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare dhe shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare.

5. **“Fond pensional vullnetar”** është fond i hapur investues, i themeluar dhe udhëhequr nga shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, ose shoqëria për udhëheqje vetëm me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, në pajtim me këtë ligj.

6. **“Fond i obligueshëm pensional”** është fondi i themeluar dhe i udhëhequr nga shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme, ose shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, në pajtim me Ligjin për sigurimin e obligueshëm pensional me financim kapital dhe në pajtim me këtë ligj.

7. **“Agjenci”** është Agjencia për supervizionin e sigurimit pensional me financim kapital, që e rregullon dhe e mbikëqyr sigurimin pensional të obligueshëm dhe vullnetar me financim kapital.

8. **“Ruajtës i pronës”** është banka ose institucioni i specializuar depozitar, të cilës shoqëria që udhëheq me fonde pensionale vullnetare dhe shoqëria që udhëheq me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, ia ka besuar përgjegjësinë për ruajtjen e mjeteve të fondeve pensionale vullnetare, dhe kryen aktivitete të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

9. **“Institucion financiar”** është banka, shoqëria për sigurim, shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale, shoqëria për udhëheqje me mjete ose institucioni i ngjashëm financiar.

10. **“Sigurues”** është punëdhënësi ose shoqata e qytetarëve me seli në Republikën e Maqedonisë, që e organizon dhe financon skemën profesionale pensionale dhe paguan kontribute vullnetare në fondin pensional vullnetar, për të punësuarit ose anëtarët e vet.

11. **“Skemë pensionale profesionale”** është skema e kontraktuar ndërmjet punëdhënësit dhe personave të tij të punësuar, ose shoqatës së qytetarëve dhe anëtarëve të saj, e lidhur në fondin pensional vullnetar.

12. **“Person i lidhur”** në raport me personin e caktuar fizik ose juridik, është:

a) aksionari individual ose një grup aksionarësh, që posedojnë së paku 20% të aksioneve me të drejtë vote ose nëse posedojnë përqindje më të vogël, mund të kenë kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj vendimmarrjes, te ai person juridik;

b) cilido person tjetër juridik te i cili personi i parë juridik, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë posedon së paku 20% të aksioneve me të drejtë vote ose nëse posedon përqindje më të vogël, mund të kenë kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj vendimmarrjes, te ai person juridik;

c) cilido person tjetër juridik te i cili një aksionar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë posedon më tepër se 30% të aksioneve me të drejtë vote, dhe në të njëjtën periudhë kohore aksionari i njëjtë posedon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë më tepër se 30% të aksioneve me të drejtë vote, te personi i parë juridik;

ç) personi fizik, ose personat që kanë kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ose janë të kontrolluar nga, ose janë nën kontrollin e përbashkët të personit juridik;

d) anëtari i këshillit drejtues, këshillit mbikëqyrës ose anëtari i organit tjetër të udhëheqjes ose mbikëqyrjes të personit juridik dhe

dh) cilido anëtar i familjes më të ngushtë ose farefis, përfundimisht me shkallën e dytë të farefisit sipas gjakut, lidhur me personat e shënuar në këtë pikë.

13. **“Kontroll”** sipas pikës 12 të këtij neni, është kur një person:

a) në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, posedon depozitë shumice te personi tjetër juridik ose

b) në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, posedon shumicën e të drejtave të votës te personi tjetër juridik, ose

c) ka të drejtë që të caktojë dhe shkarkojë shumicën e anëtarëve të organeve të udhëheqjes të personit tjetër juridik, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke përfshirë edhe marrëveshjen e lidhur me një apo më tepër aksionarë të personit tjetër juridik, për lëshimin ose bashkimin e të drejtave të tyre të votës, për realizimin e interesave të përbashkëta, ose

ç) ka të drejtë që të realizohet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndikimi i konsiderueshëm ndaj udhëheqjes dhe miratimit të politikave dhe vendimeve financiare dhe afariste të personit tjetër juridik.

14. **“Anëtar”** është personi fizik që ka lidhur marrëveshje për anëtarësim në fondin pensional vullnetar dhe ka llogari individuale vullnetare, ose ka vërtetim për anëtarësi nga shoqëria që udhëheq me fondin pensional, në të cilin person është anëtar dhe ka llogari profesionale.

15. **“Llogari vullnetare individuale”** është llogaria në emër të personit në fondin pensional vullnetar, në të cilin anëtari ose personi tjetër, paguan kontribute vullnetare në bazë vullnetare.

16. **“Llogari profesionale”** është llogaria në fondin pensional vullnetar, në emër të të punësuarit, në të cilën vetëm punëdhënësi paguan kontribut vullnetar, ose në emër të anëtarit të shoqatës së qytetarëve në të cilën vetëm shoqata paguan kontribut vullnetar.

17. **“Bartje”** është bartja e mjeteve nga njëra në llogarinë tjetër individuale të anëtarit, në fondin e njëjtë ose fondin tjetër pensional vullnetar.

18. **“Provizione transaksioni”** janë kompensimi për bursën e letrave me vlerë, kompensimi për depozitarin e letrave me vlerë dhe provizioni për personat juridikë që kryejnë shërbime me letra me vlerë, drejtpërdrejt të lidhura me tregtinë me mjetet e fondeve pensionale vullnetare.

19. **“Agjent”** është personi fizik që kryen punë të marketingut të fondeve pensionale, dhe lidh marrëveshje për anëtarësim.

20. **“Kompensim pensional”** është kompensimi që paguhet nga sigurimi pensional vullnetar me financim kapital.

KREU 2 FONDI PENSIONAL VULLNETAR

Neni 5

(1) Fondi pensional vullnetar është fond i hapur investues, që themelohet dhe punon në pajtim me Ligjin për fondet investuese, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe. Fondin pensional vullnetar e përbëjnë mjetet nga kontributet vullnetare (në tekstin e mëtejme: kontributet), të paguara në emër dhe për llogari të anëtarëve të atij fondi dhe të ardhurat nga kontributet e investuara, të zvogëluara për kompensimet që arkëtohen nga fondi pensional vullnetar.

(2) Pronarë të fondit pensional vullnetar janë anëtarët e tij, të drejtat individuale pronësore të të cilëve, janë të përcaktuara varësisht nga shuma e mjeteve të llogarive të tyre, në pajtim me nenin 101 nga ky ligj.

(3) Mjetet e fondit pensional vullnetar, janë plotësisht të ndara nga mjetet e shoqërisë që udhëheq me atë fond.

Neni 6

Me mjetet e fondit pensional vullnetar, udhëheq shoqëria që e përfaqëson dhe prezanton fondin pensional para personave të tretë.

Neni 7

Selia e fondit pensional vullnetar, është në selinë e shoqërisë që udhëheq me atë fond pensional.

Neni 8

Emri i secilit fond pensional vullnetar, detyrimisht i përmban fjalët “Fondi pensional vullnetar”.

Neni 9

Mjetet e fondit pensional vullnetar, nuk mund të bëhen lëndë e kërkesave, as që ndaj atyre mjeteve mund të zbatohet përmbarimi nga ana e, ose në emër të kreditorëve të shoqërisë që udhëheq me atë fond pensional.

Neni 10

(1) Fondi pensional vullnetare e ka statutin që përmban:

a) parime themelore dhe kufizime të veçanta gjatë investimit, krahas atyre të përcaktuara me ligj, mënyrën dhe organin për marrjen dhe zbatimin e vendimeve investuese;

b) mënyrën e llogaritjes së provizioneve transaksionale, të lidhura drejtpërdrejt me shitjen dhe blerjen e mjeteve të fondit pensional vullnetar dhe heqjen e tyre nga fondi pensional;

c) heqjet nga mjetet e fondit pensional vullnetar, për shkak të pagesës së kompensimeve të shoqërisë;

ç) mënyrën e udhëheqjes së kontabilitetit të fondit pensional vullnetar;

d) mënyrën e informimit të anëtarëve të fondit pensional vullnetar, dhe gazetën ditore në të cilën botohet prospekti informativ i fondit pensional dhe

dh) të dhëna të tjera me rëndësi për fondin pensional vullnetar.

(2) Agjencia për supervizionin e sigurimit pensional vullnetar me financim kapital (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia), jep pëlqim për statutin e fondit pensional vullnetar.

Neni 11

Së paku një herë në vit, shoqëria që udhëheq me fondin pensional vullnetar, përgatit raporte financiare për fondin pensional vullnetar. Të dhënat e përmbajtura në raportet financiare, duhet të përgatiten në pajtim me nenin 129 të këtij ligji, të jenë konsistente dhe gjithëpërfshirëse dhe ta tregojnë gjendjen e vërtetë për mjetet e fondit pensional vullnetar.

Neni 12

(1) Një shoqëri mund të themelojë dhe të udhëheqë vetëm një fond pensional vullnetar.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëritë mund të udhëheqin me më tepër se një fond pensional vullnetar, në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia, pas pëlqimit paraprak nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Agjencia e përcakton datën nga e cila të gjitha shoqëritë mund të fillojnë me udhëheqje me më tepër se një fond pensional vullnetar, numrin e fondeve pensionale vullnetare me të cilat mund të udhëheqë një shoqëri, parametrat për portofolin investues, mënyrën e bartjes së mjeteve ndërmjet fondeve pensionale vullnetare me të cilat udhëheq shoqëria e njëjtë, dhe çështje të tjera për të cilat Agjencia konsideron se janë me rëndësi, në bazë të kushteve dhe shkallës së zhvillimit të sigurimit pensional vullnetar me financim kapital dhe tregut financiar.

KREU 3

SHOQËRIA PËR UDHËHEQJE ME FONDE PENSIONALE VULLNETARE DHE SHOQËRIA PËR UDHËHEQJE ME FONDE PENSIONALE TË OBLIGUESHME DHE VULLNETARE

Neni 13

Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare dhe shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, themelohet dhe punon në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 14

Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare dhe shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, mund të themelohet dhe të punojë vetëm si shoqëri aksionare.

Neni 15

(1) Emri i çdo shoqërie për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, doemos duhet t'i përmbajë fjalët "shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare".

(2) Emri i çdo shoqërie për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, doemos duhet t'i përmbajë fjalët "shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Neni 16

(1) Veprimtari e vetme e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, është udhëheqja me fonde pensionale vullnetare, përfaqësimi i tyre para personave të tretë, si dhe veprimtari të tjera të lidhura me udhëheqjen me fonde pensionale vullnetare.

(2) Veprimtari e vetme e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, është udhëheqja me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, përfaqësimi i tyre para personave të tretë, si dhe veprimtari të tjera të lidhura me udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare.

Neni 17

(1) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, arkëton kompensim në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, arkëton kompensim në kushte dhe mënyrë të përcaktuara në Ligjin për sigurimin pensional të obligueshëm me financim kapital dhe në këtë ligj.

Neni 18

(1) Kapitali themelues i shoqërisë, nuk mund të rritet përmes emetimit publik të aksioneve.

(2) Aksionet e shoqërisë janë aksione të thjeshta në emër.

(3) Shoqëria nuk mund të emetojë aksione prioritare.

(4) Aksionarët e shoqërisë, sipas pjesëmarrjes së tyre në kapitalin e shoqërisë, kanë pozitë të barabartë në shoqëri. Me statutin e shoqërisë nuk mund t'u jepen më shumë të drejta ose privilegje aksionarëve të veçantë, ose t'u kufizohen të drejtat ose t'u ngarkohen obligime plotësuese.

(5) Asnjë marrëveshje e aksionarëve ose dokument tjetër, nuk do të ketë vlefshmëri, nëse përmban dispozita në kundërshtim me kushtet nga paragrafi (4) i këtij neni.

Neni 19

(1) Kapitali themelues i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, është së paku 500 000 euro.

(2) Aksionarët e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, janë të obliguar që në afat prej 45 ditësh pune, ta zmadhojnë kapitalin aksionar të shoqërisë për 500 000 euro përmes depozitimeve, kur mjetet e fondit pensional vullnetar i tejkalojnë 500 000 euro, dhe në çdo rast të ardhshëm kur mjetet e fondit pensional vullnetar do të zmadhohen për 50 000 000 euro të mëtutjeshme.

(3) Eurot nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, llogariten në kundërvlerë me denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në ditën e pagesës.

Neni 20

(1) Kapitali themelues i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, është së paku 1 800 000 euro.

(2) Aksionarët e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, janë të obliguar që në afat prej 45 ditësh pune, ta zmadhojnë kapitalin aksionar të shoqërisë për 1 000 000 euro përmes depozitimeve, kur mjetet e fondit pensional të obligueshëm me të cilin udhëheq ajo shoqëri i tejkalojnë 1 000 000 euro, dhe në çdo rast të ardhshëm kur mjetet e fondit pensional të obligueshëm, do të zmadhohen për 100 000 000 euro të mëtutjeshme. Gjithashtu në afat prej 45 ditësh pune, aksionarët janë të obliguar që ta zmadhojnë kapitalin aksionar të shoqërisë për 500 000 euro përmes depozitimeve, kur mjetet e fondit pensional vullnetar me të cilin udhëheq ajo shoqëri i tejkalojnë 50 000 000 euro, dhe në çdo rast të ardhshëm kur mjetet e fondit pensional vullnetar do të zmadhohen për 50 000 000 euro të mëtutjeshme.

(3) Eurot nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, llogariten në kundërvlerë me denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në ditën e pagesës.

Neni 21

(1) Kapitali themelues i shoqërisë, paguhet vetëm me mjete në para.

(2) Kapitali themelues i shoqërisë paguhet në tërësi, para regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.

(3) Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, është i obliguar që ta njoftojë Agjencinë për çdo ndryshim të kapitalit themelues të shoqërisë, në afat prej tri ditësh nga regjistrimi i kryer.

(4) Kapitali themelues i shoqërisë paguhet në llogarinë e hapur në bankë ose në bankë të huaj që ka leje të punojë në territorin e Republikës së Maqedonisë, në pajtim me ligjin.

Neni 22

(1) Kapitali themelues i shoqërisë, nuk guxon të rrjedhë nga huat ose kreditë, as të jetë i ngarkuar në çfarëdo mënyre.

(2) Kapitali themelues i shoqërisë doemos duhet të rrjedhë nga burime ligjore, dhe të jetë i tatuar në pajtim me dispozitat e Republikës së Maqedonisë, dhe dispozitat e vendit në të cilin secili aksionar i huaj është themeluar si person juridik.

Neni 23

(1) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, është e obliguar që në çdo kohë ta mbajë shumën e kapitalit aksionar, por jo më pak se gjysma nga shuma e kapitalit themelues nga neni 19 paragrafi (1) i këtij ligji, e llogaritur sipas metodologjisë për llogaritje të kapitalit, të përcaktuar nga Agjencia, me ç'rast shoqëria është e obliguar që ta mbajë likuiditetin e mjeteve deri në shumë jo më të vogël se përqindja nga kapitali themelues, që e përcakton Agjencia.

(2) Nëse vjen te zmadhimi i kapitalit aksionar në pajtim me nenin 19 paragrafi (2) i këtij ligji, shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, është e obliguar që në çdo kohë ta mbajë shumën e kapitalit aksionar, por jo më pak se gjysma nga shuma e zmadhuar e atij kapitali.

(3) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, është e obliguar që në çdo kohë ta mbajë shumën e kapitalit aksionar, por jo më pak se gjysma nga shumata e kapitalit themelues nga neni 20 paragrafi (1) i këtij ligji, me ç'rast është e obliguar që të mbajë mjete likuide, në shumë jo më të vogël se përqindja nga kapitali themelues, që e përcakton Agjencia.

(4) Nëse vjen te zmadhimi i kapitalit aksionar në pajtim me nenin 20 paragrafi (2) i këtij ligji, shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, është e obliguar që në çdo kohë ta mbajë shumën e kapitalit aksionar, por jo më pak se gjysma nga shumata e zmadhuar e atij kapitali.

(5) Shoqëria është e obliguar që menjëherë ta njoftojë Agjencinë për çdo zvogëlim të kapitalit aksionar, nën shumatat e përcaktuara në paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

(6) Agjencia mund t'ia heqë lejen për udhëheqje me fondin pensional vullnetar, shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, nëse pas zvogëlimit të kapitalit nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni nën shumën e përcaktuar, shoqëria nuk e kryen zmadhimin e kapitalit deri në atë shumë, në afatin që vet do ta përcaktojë por jo më të shkurtër se 90 ditë dhe jo më të gjatë se një vit.

(7) Agjencia mund t'ia heqë lejen për udhëheqje me fondin pensional vullnetar dhe/ose lejen për udhëheqje me fondin pensional të obligueshëm, shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, nëse pas zvogëlimit të kapitalit nga paragrafi (3) dhe (4) të këtij neni nën shumën e përcaktuar, shoqëria nuk e kryen zmadhimin e kapitalit deri në atë shumë, në afatin që vet do ta përcaktojë por jo më të shkurtër se 90 ditë dhe jo më të gjatë se një vit.

Neni 24

(1) Shoqëri mund të themelojnë personat juridikë vendës dhe të huaj.

(2) Themeluesit që posedojnë 51% ose më tepër nga kapitali themelues i shoqërisë janë institucionet financiare, si dhe personat e tjerë juridikë të cilët drejtpërdrejt ose tërthorazi posedojnë më tepër se 50% të aksioneve me të drejtë udhëheqjeje të institucioneve financiare.

(3) Personi i njëjtë juridik mund të jetë aksionar vetëm në një shoqëri, për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare.

(4) Personi i njëjtë juridik mund të jetë aksionar vetëm në një shoqëri, për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare.

(5) Aksionari i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, mund të jetë aksionar i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme.

(6) Aksionari i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, nuk mund të jetë aksionar as i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme as i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare.

(7) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme me seli në Republikën e Maqedonisë, nuk mund të jetë aksionar në shoqërinë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare as në shoqërinë për udhëheqje me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare, me seli në Republikën e Maqedonisë dhe anasjelltas.

(8) Siguruesi mund të jetë aksionar në shoqëri, në pajtim me ligjin.

(9) Personat e lidhur juridikë munden bashkërisht të jenë aksionarë vetëm në një shoqëri, përveç në rastin nga paragrafi (5) i këtij neni.

(10) Nëse vjen deri te prishja e marrëdhënieve të vendosura të përcaktuara me paragrafin (3), (4), (5), (6), (7), (8) dhe (9) të këtij neni, për shkak të ndryshimeve organizative statusore, ndryshimeve në pronësi ose pozitën juridike të personave juridikë, ata janë të obliguar që ta kryejnë harmonizimin përkatës me dispozitat e këtij ligji, në afat prej 180 ditësh nga ndryshimi i ndodhur.

Neni 25

(1) Themelues të shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, që posedojnë 15% ose më tepër nga kapitali themelues i shoqërisë, mund të jenë institucionet financiare që i plotësojnë kushtet si vijojnë:

a) të ketë:

1) mjete personale së paku në shumë prej 9 000 000 eurosh me kundërvlerë në denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në ditën e paraqitjes për leje, nëse është bankë;

2) kryegjënë bazë së paku në shumë prej 3 000 000 eurosh me kundërvlerë në denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në ditën e paraqitjes për leje, nëse është shoqëri për sigurim;

3) kryegjënë bazë së paku në shumë prej 500 000 eurosh me kundërvlerë në denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në ditën e paraqitjes për leje, nëse është shoqëri për udhëheqje me fonde investuese;

4) kryegjënë bazë së paku në shumë prej 1 000 000 eurosh me kundërvlerë në denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në ditën e paraqitjes për leje, nëse është shoqëri e huaj për udhëheqje me fonde pensionale dhe

5) kryegjënë bazë së paku në shumë prej 5 000 000 eurosh me kundërvlerë në denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në ditën e paraqitjes për leje, për institucionet e tjera financiare.

b) të jetë i regjistruar dhe të ketë punuar së paku tre vite;

c) të jetë në kontinuitet solvent, në punën e tij në Republikën e Maqedonisë ose jashtë vendit dhe

ç) të ketë ekip menaxherësh të përbërë nga persona kompetentë, profesionalë dhe me përvojë.

(2) Themelues i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, që posedon 51% ose më tepër nga kapitali themelues i shoqërisë, mund të jetë personi juridik që posedon më tepër se 50% të aksioneve me të drejtë udhëheqjeje të institucionit financiar, që i plotëson kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Themelues i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, që posedon më pak se 51% nga kapitali themelues i shoqërisë, mund të jetë personi juridik që i plotëson kushtet nga paragrafi (1) pikat b), v) dhe g) të këtij neni.

Neni 26

(1) Themelues i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare , mund të jetë personi juridik që i plotëson kushtet si vijojnë:

a) të ketë kapital së paku në shumë prej 20 000 000 eurosh me kundërvlerë në denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në ditën e paraqitjes për leje;

b) të jetë i regjistruar dhe të ketë punuar së paku tre vite;

c) të jetë në kontinuitet solvent në punën e tij, në Republikën e Maqedonisë ose jashtë vendit dhe

ç) të ketë ekip të përhershëm menaxherësh, të përbërë nga persona kompetentë, profesionalë dhe me përvojë.

(2) Nëse si themelues paraqitet institucioni i huaj financiar, përveç kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni, doemos duhet të ketë rejting të preferueshëm për investim sipas agjencive rejtingu kreditore ndërkombëtare me renome, së paku në periudhën prej një viti para se të paraqitet si themelues.

(3) Agjencia më afërsisht i përcakton kushtet nga neni 24 dhe 25 të këtij ligji, dhe paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni.

Neni 27

(1) Çdo fitim ose bartje e aksioneve të shoqërisë, i nënshtrohet paraprakisht pajtimit nga Agjencia, në të kundërtën konsiderohen të pavlefshme.

(2) Shoqëria dorëzon në Agjenci kërkesë për pëlqim për fitimin ose bartjen e aksioneve, nga emri i personit që ka për qëllim të fitojë aksione ose t'i bartë aksionet.

(3) Agjencia jep pëlqim për fitimin ose bartjen e aksioneve të shoqërisë, në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, nëse kërkuesi i plotëson kushtet ligjore që të bëhet themelues i shoqërisë.

(4) Obligimi nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk ka të bëjë edhe me transaksionet me aksione kur pas transaksionit të kryer, blerësi ose personi i lidhur me atë, bashkërisht nuk kanë fituar më tepër se 3% të kapitalit aksionar të shoqërisë.

Neni 28

(1) Shoqëria ka këshill drejtues dhe mbikëqyrës.

(2) Këshilli drejtues i shoqërisë, përbëhet së paku nga tre anëtarë.

(3) Këshilli mbikëqyrës i shoqërisë, përbëhet së paku nga tre anëtarë.

(4) Për anëtar të këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës, mund të emërohet personi i cili përveç kushteve të përcaktuara me Ligjin për shoqëri tregtare, i përmbush edhe kushtet në vijim:

a) të ketë arsimin sipëror;

b) të ketë përvojë pune prej së paku pesë vitesh në sferën e drejtësisë, bankare, kontabilitetit, sigurimit, udhëheqjes me mjete dhe investimit, udhëheqjes me fonde pensionale ose shërbime financiare dhe

c) të mos i është kumtuar sanksion kundërvajtës, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në sferat e shënuara në pikën b) të këtij paragrafi.

Neni 29

(1) Anëtari i këshillit drejtues, i këshillit mbikëqyrës përkatësisht drejtor gjeneral ose drejtor i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, nuk mund të bëhet anëtar i këshillit drejtues ose i këshillit mbikëqyrës, ose të punojë si drejtor gjeneral ose drejtor te:

a) shoqëria tjetër për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare;

b) shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme;

c) shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare;

ç) menaxheri i huaj që është zgjedhur të udhëheqë me mjetet e fondit pensional vullnetar;

d) ruajtësi i pronës në të cilin ruhen mjetet e fondit pensional vullnetar dhe

dh) secili person që e ka statusin e personit të lidhur me subjektet nga pikat a), b), c), ç) dhe d) të këtij paragrafi.

(2) Me përjashtim, ndalimi nga paragrafi (1) pika b) e këtij neni, nuk ka të bëjë me anëtarët e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme, në rastin kur shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, janë persona të lidhur.

(3) Ndalimi nga paragrafi (1) i këtij neni, ka të bëjë edhe me personat që janë të punësuar ose të lidhur në bazë të marrëveshjes për vepër, me subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Personi nga paragrafi (1), (2) dhe (3) të këtij neni, është i obliguar që t'i plotësojë kushtet nga ky nen, nga dita kur do të emërohet si anëtar i këshillit drejtues ose i këshillit mbikëqyrës të shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, përkatësisht drejtor gjeneral ose drejtor. Këto kushte personi nuk është i obliguar që t'i plotësojë në kohën e paraqitjes për leje për themelimin e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare ose kërkesës për pëlqim për anëtarësim në këshillin drejtues ose mbikëqyrës.

Neni 30

(1) Anëtari i këshillit drejtues, i këshillit mbikëqyrës përkatësisht drejtori gjeneral ose drejtori i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, nuk mund të bëhet anëtari i këshillit drejtues ose i këshillit mbikëqyrës, ose të punojë si drejtor gjeneral ose drejtor te:

- a) shoqëria tjetër për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare;
 - b) shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare;
 - c) shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme;
 - ç) menaxheri i huaj që është zgjedhur të udhëheqë me mjetet e fondeve pensionale me të cilat udhëheq;
 - d) ruajtësi i pronës në të cilin ruhen mjetet e fondeve pensionale me të cilat udhëheq dhe
 - dh) secili person që e ka statusin e personit të lidhur me subjektet nga pikat a), b), v), g) dhe
- d) të këtij paragrafi.

(2) Ndalimi nga paragrafi (1) i këtij neni, ka të bëjë edhe me personat që janë të punësuar ose të lidhur në bazë të marrëveshjes për vepër, me subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Personi nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, është i obliguar që t'i plotësojë kushtet nga ky nen, nga dita kur do të emërohet si anëtar i këshillit drejtues ose i këshillit mbikëqyrës të shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare. Këto kushte personi nuk është i obliguar që t'i plotësojë në kohën e paraqitjes për leje për themelimin e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, ose kërkesës për pëlqim për anëtarësim në këshillin drejtues ose mbikëqyrës.

Neni 31

(1) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, është përgjegjëse para anëtarëve të fondit pensional vullnetar, për dëmet që janë shkaktuar si rezultat i moskryerjes, kryerjes së parregullt ose të papërgjegjshme të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara në këtë ligj, lidhur me udhëheqjen dhe përfaqësimin e fondit të veçantë pensional vullnetar, përveç nëse rezultatet e dobëta apo jopërkatëse i referohen rrethanave në të cilat shoqëria nuk ka mundur që të ndikojë, dhe të cilat nuk kanë mundur që të ndryshohen nga ana e shoqërisë edhe në rast të shkallës më të lartë të përgjegjshmërisë.

(2) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, është përgjegjëse para anëtarëve të fondit pensional të obligueshëm dhe vullnetar, për dëmet që janë shkaktuar si rezultat i moskryerjes, kryerjes së parregullt ose të papërgjegjshme të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara në këtë ligj, lidhur me udhëheqjen dhe përfaqësimin e fondit të veçantë pensional, përveç nëse rezultatet e dobëta apo jopërkatëse i referohen rrethanave në të cilat shoqëria nuk ka mundur të ndikojë, dhe të cilat nuk kanë mundur të ndryshohen nga ana e shoqërisë, edhe në rast të shkallës më të lartë të përgjegjshmërisë.

(3) Dëmet nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, që kanë ndodhur për shkak të moskryerjes, kryerjes së parregullt ose të papërgjegjshme të detyrave dhe obligimeve, nuk guxojnë që të mbulohen nga mjetet e fondit pensional.

(4) Bartja e kryerjes së obligimeve të veçanta te personi i tretë, nuk e liron shoqërinë nga përgjegjësia.

Neni 32

(1) Shoqëria nuk guxon që t'i shfrytëzojë mjetet e veta për:

- a) fitimin dhe marrjen e aksioneve dhe letrave të tjera me vlerë ose depozitimeve në personat e tjerë juridikë, përveç për fitimin e shkresave dhe obligacioneve shtetërore, të lëshuara nga Republika e Maqedonisë;
- b) dhënien e huave dhe sigurimin e garancive ose sigurime të tjera, përveç atyre të përcaktuara me këtë ligj;

c) marrjen e huave dhe kredive dhe emetimin e obligacioneve, në vlerë të përgjithshme që e tejkalon përqindjen e caktuar nga kapitali i vet, të cilën përqindje e përcakton Agjencia, ose

ç) blerjen ose shitjen e letrave me vlerë, nëse me tregtinë e këtillë do të pamundësohej blerja ose shitja e letrave me vlerë nga mjetet e fondit pensional me të cilin udhëheq, ose nëse blerja ose shitja e letrave me vlerë me mjetet e fondit pensional, do të realizohej me kushte më të pavolitshme për atë fond.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) pika a) e këtij neni, shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, mund t'i shfrytëzojë mjetet e veta për blerjen e aksioneve, në subjektin që kryen punë të evidentimit, tregtisë me letra afatgjate me vlerë, marketingut ose veprimtari të tjera administrative të shoqërisë, me kusht që ai subjekt t'i kryejë shërbimet ekskluzivisht për atë shoqëri ose për shoqërinë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme, që është person i lidhur me shoqërinë.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (1) pika a) e këtij neni, shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, mund t'i shfrytëzojë mjetet e veta për blerjen e aksioneve, në subjektin që kryen punë të evidentimit, tregtisë me letra afatgjate me vlerë, marketingut ose veprimtari të tjera administrative të shoqërisë, me kusht që ai subjekt t'i kryejë shërbimet ekskluzivisht për atë shoqëri.

(4) Nëse shoqëria ka për qëllim që të blejë aksione në subjekte të tjera në pajtim me paragrafin (2) dhe (3) të këtij neni, kapitali i përgjithshëm për ato blerje bashkë me çmimin e paguar për të gjitha blerjet e përparshme të aksioneve që i posedon shoqëria, nuk mund të tejkalojë 10% të shumës së përgjithshme të kapitalit aksionar të asaj shoqërie, në datën e blerjes.

Neni 33

(1) Shoqëria është e obliguar që të mbajë evidencë të plotë, të saktë dhe të përditësuar, për llogaritë individuale të secilit anëtar të fondit pensional me të cilin udhëheq, për kontributet e paguara dhe mjetet e bartura për anëtarin, numrin e njërive përlllogaritëse të llogarisë dhe vlerën e llogarisë së anëtarit, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Shoqëria është e obliguar që t'i arkivojë dhe ruajë në pajtim me ligjin, të gjitha dokumentet dhe evidencën tjetër, lidhur me fondin pensional me të cilin udhëheq, e veçanërisht:

a) të dhënat për anëtarët dhe anëtarët e përparshëm, duke përfshirë emrin, mbiemrin dhe adresën, numrin unik amë dhe shumën e llogarisë individuale në momentin e lëshimit të fondit pensional dhe.

b) të dhënat për të gjitha mjetet e blera dhe të shitura për fondin pensional me të cilin udhëheq, datën e transaksioneve, identitetin e palës tjetër kontraktuese dhe çmimin e realizuar.

(3) Të gjitha dokumentet dhe evidenca tjetër, doemos duhet të ruhen për periudhën prej 50 vitesh.

(4) Pas kalimit të kohës prej dhjetë vitesh nga krijimi i ndonjë dokumenti ose evidence, i njëjti mund të ruhet vetëm si shkresë elektronike.

(5) Shoqëria është e obliguar që të sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale të anëtarëve të fondeve pensionale, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

(6) Në rast se shoqëria pushon të udhëheqë me fondin pensional, është e obliguar që të veprojë në pajtim me dispozitat nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni.

(7) Agjencia e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes, arkivimit dhe ruajtjes së evidencës, nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni.

Neni 34

(1) Shoqëria është e obliguar që të ketë njësi të veçantë organizative për revizion të brendshëm, e cila për punën e vet mban përgjegjësi para këshillit mbikëqyrës të shoqërisë.

(2) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni, kryen kontroll të përhershëm dhe të plotë të ligshmërisë dhe përditësimit të punës së shoqërisë, veçanërisht përmes:

- a) Përcjelljes së zbatimit të dispozitave;
- b) Përcjelljes së zbatimit të procedurave dhe politikave interne dhe
- c) Vlerësimit të efikasitetit të përgjithshëm të punës së shoqërisë.

(3) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni, përgatit program vjetor të punës për vitin e ardhshëm, dhe raport për revizionin e brendshëm për vitin e kaluar, dhe ia dorëzon për miratim këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, më së voni deri më 31 mars.

(4) Personi i punësuar në njësinë organizative nga paragrafi (1) i këtij neni, kryen punë vetëm për revizionin e brendshëm.

(5) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni, është e obliguar që t'i dorëzojë programin dhe raportin nga paragrafi (3) i këtij neni në Agjenci, njëkohësisht me dorëzimin e tyre në Këshillin mbikëqyrës të shoqërisë.

Neni 35

(1) Shoqëria është e obliguar që ta ketë revizorin e jashtëm të autorizuar, i cili nuk guxon që të jetë person i lidhur me shoqërinë ose me aksionarët e shoqërisë, menaxherin e huaj të mjeteve ose ruajtësin e pronës, dhe të cilit në tre vitet e fundit nuk i janë kumtuar masa nga ana e Institutit të revizorëve të autorizuar. Revizori i njëjtë i jashtëm i autorizuar, mund të kryejë më së shumti tre revizione të njëpasnjëshme vjetore, për shoqërinë e njëjtë.

(2) Shoqëria është e obliguar që ta publikojë ekstraktin e raportit të reviduar financiar, me mendimin e revizorit të autorizuar, në së paku një gazetë ditore dhe në ueb faqen e vet, në afat prej 15 ditësh nga miratimi i raportit nga ana e kuvendit të aksionarëve të shoqërisë.

Neni 36

(1) Përfaqësuesit e shoqërisë obligativisht marrin pjesë në trajnime nga sfera e sigurimit pensional me financim kapital, të organizuara nga Agjencia.

(2) Agjencia e përcakton llojin e trajnimeve dhe mënyrën e realizimit të tyre.

KREU 4 THEMELIMI I SHOQËRISË PËR UDHËHEQJE ME FONDE PENSIONALE VULLNETARE

Neni 37

(1) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare themelohet në bazë të lejes së lëshuar nga Agjencia, ndërsa pas themelimit, nga Agjencia merr leje për udhëheqje me fondin pensional vullnetar.

(2) Në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, kryhet regjistrimi i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, vetëm nëse ajo ka leje nga Agjencia, të lëshuar në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

(3) Agjencia më afërsisht e përcakton mënyrën për marrjen e lejes për themelim dhe lejes për udhëheqje me fondin pensional.

Neni 38

(1) Për marrjen e lejes për themelimin e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, personat e interesuar në Agjenci dorëzojnë leje me dokumentacionin e shënuar në nenin 39 të këtij ligji, dhe planin afarist që i përmban hollësitë për të gjitha kompensimet dhe provizionet që do të arkëtohen në pajtim me këtë ligj. Kërkesa për leje për udhëheqje me fondin pensional vullnetar, dorëzohet bashkë me kërkesën për leje për themelimin e shoqërisë.

(2) Kërkesat nga paragrafi (1) i këtij neni, dorëzohen të nënshkruara nga nënshkruarit e autorizuar të personit ose personave, që do të ishin themelues të shoqërisë, në formën e përcaktuar nga Agjencia. Në rast se ka më tepër persona të cilët kanë interes që të paraqiten si një kërkuar, kërkesat me dokumentacionin dërgohen bashkërisht në emër të të gjithë personave.

Neni 39

(1) Kërkesave nga neni 38 paragrafi (1) i këtij ligji, i bashkëngjitet dokumentacioni si vijon:

- a) projektstatuti i shoqërisë së ardhshme, për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare;
- b) projektstatuti i fondit pensional vullnetar, me të cilin do të udhëhiqet;
- c) projekt marrëveshja me ruajtësin e pronës;
- ç) deklaratata e nënshkruar nga nënshkruesit e autorizuar të të gjithë personave që do të ishin themelues, se nëse marrin leje do të themelojnë shoqëri për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare dhe fond pensional vullnetar, në pajtim me këtë ligj;
- d) lista e themeluesve dhe të dhënat për lidhjen e personave juridikë, dhe sqarimet për karakterin e asaj lidhjeje;

dh) për të gjithë personat që do të ishin themelues, kopje të vërtetuara nga aktet themeluese dhe statutet e shoqërive dhe ekstrakti nga organi kompetent në të cilin janë regjistruar, emrat dhe adresat e anëtarëve të këshillave drejtuese, dhe kopjet e vërtetuara nga tre raportet e fundit financiare të reviduara nga revizori i jashtëm i autorizuar, si dhe çdo dëshmi plotësuese e nevojshme që të dëshmohet se janë plotësuar kushtet nga neni 25 i këtij ligji;

e) dokumentet me të cilat vërtetohet se në datën e paraqitjes për leje, themeluesit që do të posedojnë 51% nga kapitali themelues i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, kanë përvojë të madhe në udhëheqje me mjete;

ë) dëshmia për prejardhjen e mjeteve financiare, që do të paguhet në emër të kapitalit themelues të shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare;

f) lista e kandidatëve për anëtarë të këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës të shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, bashkë me deklaratat me të cilat ata pajtohen që t'i kryejnë këto funksione nëse marrin leje për themelim, dhe t'i plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë ligj, duke përfshirë tërheqjen nga çfarëdo funksioni që paraqet konflikt të interesave dhe është i ndaluar me këtë ligj, si dhe përshkrimin e kualifikimeve të tyre profesionale dhe të përvojës së përparshme profesionale;

g) të dhënat për personat që do të jenë në vende udhëheqëse dhe personat e tjerë që propozohen të jenë përgjegjës për vendimet investuese, revizionin e brendshëm, llogaritë individuale, marketingun dhe kontrollin e agjentëve;

gj) certifikatat e personave që janë anëtarë të organeve të udhëheqjes dhe administrimit të shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, nuk u është kumtuar sanksioni kundërvajtës, ndalim për kryerjen e funksionit, veprimtarisë ose detyrës në sferën juridike, bankare, të kontabilitetit, sigurimit, menaxhimit me mjete dhe investimit, udhëheqjes me fonde pensionale dhe shërbime financiare;

h) programi për implementimin e themelimit të shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare dhe fond pensional vullnetar, si dhe programi organizativ për strukturën e shoqërisë;

i) programi për strategjinë investuese, të fondit pensional vullnetar dhe

j) dokumente të tjera që i përcakton Agjencia.

(2) Në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesave nga neni 38 paragrafi (1) i këtij ligji, Agjencia mund të kërkojë dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave plotësuese.

(3) Agjencia mundet që në mënyrë plotësuese të analizojë fakte të veçanta, lidhur me kërkesat dhe dokumentacionin dhe për këtë qëllim mundet:

a) të drejtohet te organet dhe institucionet e tjera kompetente rregulluese dhe të supervizionit, në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit dhe

b) të grumbullojë dokumente dhe të dhëna nga burimet e tjera.

Neni 40

Agjencia u lëshon leje për themelimin e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare dhe leje të kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional vullnetar kërkuarëve, në bazë të dokumenteve dhe të dhënave nga neni 39 i këtij ligji, nëse nuk është në kundërshtim me interesat e personave të cilët do të mund të anëtarësoheshin në fondin e ardhshëm pensional vullnetar, i cili do të themelohet në bazë të këtij ligji dhe pas plotësimit të kushteve si vijojnë:

a) dokumentet dhe të dhënat në disponim, tregojnë se personat e interesuar disponojnë me mjete financiare për atë dedikim;

b) nga dokumentet dhe të dhënat në disponim, tregojnë se personat e interesuar, i plotësojnë kushtet për themelues, nga neni 24 dhe 25 të këtij ligji;

c) dokumentet dhe të dhënat në disponim, tregojnë se personat e propozuar për anëtarë të këshillit drejtues dhe të këshillit mbikëqyrës, dhe personat përgjegjës për udhëheqje investuese, i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj;

ç) emri i propozuar i shoqërisë së ardhshme për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare ose emri i fondit pensional vullnetar, nuk do t'u shkaktojë huti anëtarëve të fondit, anëtarëve të ardhshëm ose cilitdo person tjetër, që do të mund të ketë kontakte me shoqërinë dhe fondin pensional dhe

d) puna e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare dhe e fondit pensional vullnetar, do të kryhet në pajtim me standardet e udhëheqjes me fonde pensionale dhe zakonet e mira afariste.

Neni 41

(1) Agjencia merr vendim për kërkesat nga neni 38 paragrafi (1) i këtij ligji, në afat prej 60 ditësh nga pranimi i kërkesave.

(2) Personave të interesuar të cilëve u janë pranuar kërkesat, Agjencia u lëshon leje për themelimin e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, dhe leje të kushtëzuar për udhëheqje me fond pensional vullnetar.

(3) Personat e interesuar të cilëve u është lëshuar leje për themelim dhe leje e kushtëzuar për udhëheqje me fond pensional, janë të obliguar që të themelojnë shoqëri, në pajtim me dokumentacionin e paraqitur, në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe këtë ligj. Shoqëria doemos duhet të themelohet në afatin prej 90 ditësh nga pranimi i lejes, ndërsa për shkaqe të arsyeshme Agjencia mundet ta vazhdojë afatin për më së shumti 90 ditë.

(4) Nëse personat e interesuar të cilëve u është lëshuar leja për themelim, nuk themelojnë shoqëri në afatin e caktuar me paragrafin (3) të këtij neni, pas kalimit të atij afati, Agjencia do ta heqë lejen për themelim.

Neni 42

(1) Personave të interesuar të cilëve nuk u është lëshuar leje, Agjencia u dërgon vendim me arsyetimin e refuzimit. Këto vendime janë të kapshme për opinionin.

(2) Kundër vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, personi i interesuar mund të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente. Padia nuk e prolongon zbatimin e vendimit.

Neni 43

(1) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, e njofton Agjencinë për themelimin dhe regjistrimin në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, në afat prej 30 ditësh nga regjistrimi i kryer. Shoqëria është e obliguar që të dorëzojë kopje të vërtetuara nga aktet themeluese dhe statuti i shoqërisë, versionet e fundit të dokumenteve nga neni 39 paragrafi (1) pikat (b) dhe (v) të këtij ligji, dhe dokumente të tjera lidhur me punën me fondin pensional vullnetar, të përcaktuara nga Agjencia.

(2) Pas plotësimit të kushteve të parapara në nenin 41 paragrafi (3) nga ky ligj dhe paragrafi (1) nga ky nen, leja e kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional vullnetar, bëhet e plotfuqishme.

(3) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, nuk mund të fillojë me aktivitetet e udhëheqjes me fondin pensional, si dhe të marketingut dhe analizës së mendimit publik, para regjistrimit në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë dhe para datës së përcaktuar nga Agjencia.

Neni 44

(1) Të gjitha ndryshimet e aksionarëve, anëtarëve të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës, personave me përgjegjësi ose ndryshimet dhe plotësimet e dokumenteve dhe të dhënave të shënuara në nenin 39 të këtij ligji, i nënshtrohen pëlqimit paraprakisht nga ana e Agjencisë, përveç nëse ndryshimet janë jashtë kontrollit të shoqërisë, ndërsa ajo i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për pengimin e atyre ndryshimeve. Për ndryshimet e shkaktuara jashtë kontrollit të shoqërisë, ajo është e obligueshme që ta njoftoj Agjencinë.

(2) Agjencia i vlerëson ndryshimet nga paragrafi (1), në pajtim me dispozitat për plotësimin e kushteve nga neni 40 i këtij ligji.

Neni 45

(1) Agjencia mundet ta tërheqë ose heqë lejen për udhëheqje me fondin pensional vullnetar të shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, nga shkaqet e njëjta për të cilat e refuzon kërkesën në pajtim me nenin 39 të këtij ligji, pas ndodhjes së kushteve nga neni 23 paragrafi (6) i këtij ligji, për shkak të mosplotësimit të kushteve për marrjen e lejes për themelimin nga neni 40 i këtij ligji, keqpërdorimit të të dhënave personale, në raste të tjera të shkeljes së rëndë të dispozitave nga ky ligj, dhe me kërkesë të shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare.

(2) Para se ta tërheqë ose heqë lejen për udhëheqje me fondin pensional vullnetar, Agjencia shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare i jep mundësi që t'i evitojë paligjshmëritë dhe parregullsitë në punë, në afatin e përcaktuar nga Agjencia, përveç nëse konsideron se mundësia e atillë do të ishte në kundërshtim me interesat e anëtarëve të fondit pensional vullnetar, ose interesit publik.

(3) Agjencia menjëherë e njofton shoqërinë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, për vendimin e tërheqjes ose heqjes së lejes për udhëheqje me fondin pensional vullnetar.

(4) Kundër vendimit të Agjencisë nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, mund të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente. Padia nuk e prolongon zbatimin e vendimit.

(5) Agjencia më afërsisht e rregullon mënyrën e tërheqjes ose heqjes së lejes për udhëheqje me fondin pensional vullnetar, nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 46

(1) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare të cilës i është tërhequr leja për udhëheqje me fondin pensional vullnetar në bazë të nenit 45 të këtij ligji, vazhdon që të punojë nën mbikëqyrjen e Agjencisë, në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia, pas pajtimit paraprakisht nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(2) Nëse shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, i hiqet leja për udhëheqje me fondin pensional vullnetar në bazë të nenit 45 të këtij ligji, për shkak të mbrojtjes së interesave të anëtarëve të fondeve pensionale, Agjencia e ndërmer administrimin dhe udhëheqjen me atë fond pensional, deri në përfundimin e vendimit për heqjen e lejes, në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia pas pajtimit paraprakisht nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(3) Kur vendimi për heqjen e lejes bëhet përfundimtar, Agjencia i shpërndan anëtarët në fondet ekzistuese pensionale vullnetare, me zgjedhje të rastësishme në mënyrë të përcaktuar nga Agjencia. Nëse nuk ka asnjë fond pensional vullnetar, Agjencia udhëheq me fondin pensional me të cilin ka udhëhequr shoqëria të cilës i është hequr leja për udhëheqje me fondin pensional vullnetar, deri në themelimin përkatësisht ndryshimin e regjistrimit të shoqërisë.

(4) Gjatë shpërndarjes së anëtarëve në fondet pensionale vullnetare, në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, Agjencia siguron që numri i anëtarëve që shpërndahet në secilin fond të veçantë pensional vullnetar, të caktohet sipas të ardhurave të fondit pensional dhe lartësisë së kompensimit nga neni 117 paragrafi (1) pika a) dhe b) e këtij ligji, që e arkëton shoqëria që udhëheq me atë fond pensional, në datën që e përcakton Agjencia.

Neni 47

Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, mund të bashkohet vetëm me shoqëri tjetër për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare.

Neni 48

(1) Me bashkimin e shoqërive nga neni 47 i këtij ligji, themelohet shoqëri e re.

(2) Shoqëria e re themelohet në bazë të lejes së lëshuar nga Agjencia, ndërsa pas themelimit, nga Agjencia merr leje për udhëheqje me fondin pensional vullnetar.

(3) Për shkak të marrjes së lejes për themelimin e shoqërisë së re për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, shoqëritë ekzistuese dorëzojnë në Agjenci kërkesë me dokumentacionin e shënuar në paragrafin (5) të këtij neni, dhe planin afarist që i përmban hollësitë për të gjitha kompensimet dhe provizionet që do të arkëtohen në pajtim me këtë ligj. Kërkesa për leje për udhëheqje me fondin pensional vullnetar, dorëzohet bashkë me kërkesën për leje për themelimin e shoqërisë.

(4) Kërkesat nga paragrafi (3) i këtij neni, dorëzohen të nënshkruara nga nënshkruesit e autorizuar të shoqërive ekzistuese për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, të cilët do të ishin themeluesit e shoqërisë së re, në formën e përcaktuar nga Agjencia.

(5) Kërkesave nga paragrafi (3) i këtij neni, shoqëritë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, duhet t'ua bashkëngjisin dokumentet si vijojnë:

a) vendimin për bashkim, të marrë nga organi kompetent i secilës nga shoqëritë;

b) marrëveshjen për bashkimin e shoqërive;

c) planin organizativ dhe financiar, për implementimin e shoqërisë së re;

ç) emrin e shoqërisë së re dhe të fondit të ri pensional;

d) Informacionet për atë nëse aksionarët janë persona të lidhur;

dh) dokumentet për gjendjen financiare të aksionarëve të secilës shoqëri, për të gjitha vitet nga themelimi i saj, e më së shumti për periudhën prej pesë vitesh që i paraprin datës së dorëzimit të kërkesës, duke përfshirë edhe dokumentet me të cilat vërtetohet se asnjë prej aksionarëve, nuk ka tatime dhe kontribute të mbetura të papaguara për sigurim social;

e) prospektin e reviduar informativ, për fondin e ri pensional vullnetar;

ë) Projektstatutin e fondit të ri pensional vullnetar, në të cilën shënohen kompensimet e planifikuara;

f) Projektmarrëveshjen me ruajtësin e pronës për fondin e ri pensional vullnetar dhe hollësitë për shkëputjen e marrëveshjeve ekzistuese;

g) Emrat e anëtarëve të propozuar të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës, e nëse këta persona nuk janë pjesë nga shoqëritë të cilat bashkohen, edhe informacione nga neni 39 paragrafi (1) pika z) e këtij ligji;

gj) Të dhënat për personat që do të jenë në vende udhëheqëse dhe persona të tjerë që propozohen të jenë përgjegjës për vendimet investuese, revizionin e brendshëm, llogaritë individuale, marketingun dhe kontrollin e agjentëve;

h) Programin për strategjinë investuese të fondit të ri pensionale vullnetar;

i) Dokumente të tjera që i përcakton Agjencia.

(6) Agjencia lëshon leje për themelimin e shoqërisë së re për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare dhe leje për udhëheqje me fondin pensional vullnetar, në bazë të dokumenteve nga paragrafi (5) i këtij neni, dhe pas plotësimit të kushteve nga ky ligj.

(7) Shoqëria e re për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare është trashëgimtar juridik, i të dyja shoqërive për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, të cilat e kanë themeluar.

(8) Agjencia më afërsisht e rregullon mënyrën e bashkimit të shoqërive nga neni 47 i këtij ligji, dhe të fondeve pensionale nga neni 50 paragrafi (1) i këtij ligji.

Neni 49

Agjencia mundet ta refuzojë kërkesën për bashkimin e shoqërive për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, nëse:

- a) Kërkesa me dokumentacionin nuk i plotësojnë kushtet nga ky lig;
- b) Dokumentet e bashkëngjitura kërkesës ose informatat e tjera, tregojnë se cilado nga shoqëritë që bashkohet në periudhën prej pesë vitesh para paraqitjes së kërkesës, ka borxhe të mbetura në bazë të tatimeve ose kontributeve të papaguara për sigurim social.
- c) Aksionet e cilësdo shoqëri rrjedhin nga huamarrja, kredia ose janë të ngarkuara në çfarëdo mënyre.
- ç) Aktivitetet afariste të parashtruesve të kërkesës nuk garantojnë se shoqëria e re dhe fondet pensionale me të cilat do të udhëheqë, do të udhëhiqen në interesin më të mirë të anëtarëve dhe
- d) Me bashkim rrezikohen interesat e anëtarëve të fondeve pensionale, ose interesi tjetër publik

Neni 50

(1) Fondet pensionale vullnetare bashkohen në të njëjtën kohë me shoqëritë të cilat kanë udhëhequr me ato fonde pensionale, dhe themelohet një fond pensional vullnetar.

(2) Pas bashkimit të fondeve pensionale nga paragrafi (1) i këtij neni, fondi i ri pensional vullnetar i ndërmerr të drejtat dhe obligimet nga fondet pensionale që janë bashkuar.

Neni 51

Para bashkimit të shoqërive nga neni 47 i këtij ligji, shoqëritë me shkrim i njoftojnë të gjithë anëtarët dhe siguruesit për vendimin e bashkimit. Pas bashkimit, shoqëria e re për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, i njofton të gjithë anëtarët dhe siguruesit për emrin e shoqërisë së re, emrin e fondit të ri pensional, dhe u dorëzon kopje nga prospekti informativ, statuti i shoqërisë së re dhe statuti i fondit të ri pensional.

Neni 52

(1) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, mundet të bashkohet vetëm me shoqëri për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare.

(2) Në rast të bashkimit të njëres me shoqëri tjetër nga paragrafi (1) i këtij neni, fondi pensional vullnetar me të cilin udhëheq shoqëria e cila bashkohet, bashkohet me fondin pensional vullnetar, me të cilin udhëheq shoqëria me të cilën kryhet bashkimi.

(3) Para bashkimit të fondeve pensionale vullnetare, shoqëria me të cilën kryhet bashkimi, me shkrim i njofton të gjithë anëtarët dhe siguruesit.

(4) Me bashkimin e njërit me tjetrin fond pensional vullnetar, anëtarët, llogaritë vullnetare individuale dhe llogaritë profesionale nga fondi pensional i cili bashkohet, barten në fondin pensional me të cilin bashkohen.

(5) Agjencia më afërsisht e përcakton mënyrën e bashkimit të shoqërive dhe fondeve pensionale nga ky nen.

KREU 5

THEMELIMI I SHOQËRISË PËR UDHËHEQJE ME FONDE PENSIONALE TË OBLIGUESHME DHE VULLNETARE

Neni 53

(1) Shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, themelohet në bazë të lejes për themelim të lëshuar nga Agjencia, ndërsa pas themelimit nga Agjencia merr leje për udhëheqje me fondin pensional të obligueshëm dhe leje për udhëheqje me fondin pensional vullnetar.

(2) Në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, do të kryhet regjistrimi i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, vetëm nëse ajo ka leje nga Agjencia, e lëshuar në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

(3) Agjencia më afërsisht e përcakton mënyrën e marrjes së lejes për themelim dhe lejes për udhëheqje me fonde pensionale.

Neni 54

(1) Për marrjen e lejes për themelimin e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, personat e interesuar në Agjenci dorëzojnë kërkesë me dokumentacionin e shënuar në nenin 55 të këtij ligji, dhe planin afarist që i përmban hollësitë për të gjitha kompensimet dhe provizionet që do të arkëtohen në pajtim me këtë ligj. Kërkesat për leje për udhëheqje me fondin pensional të obligueshëm dhe vullnetar, dorëzohen bashkë me kërkesën për leje për themelimin e shoqërisë.

(2) Kërkesat nga paragrafi (1) i këtij neni, dorëzohen të nënshkruara nga nënshkruesit e autorizuar të personit ose personave, që do të ishin themelues të shoqërisë, në formën e përcaktuar nga Agjencia. Në rast se ka më tepër persona që kanë interes që të paraqiten si një kërkuar, kërkesat me dokumentacionin dërgohen bashkërisht në emër të të gjithë personave.

Neni 55

(1) Kërkesave nga neni 54 paragrafi (1) i këtij ligji, u bashkëngjitet dokumentacioni si vijon:

a) projektstatuti i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare;

b) projektstatutet e fondeve pensionale, me të cilat do të udhëheqë;

c) projekt marrëveshja me ruajtësin e pronës;

ç) deklarata e nënshkruar nga nënshkruesit e autorizuar të të gjithë personave që do të ishin themelues, nëse marrin leje se do të themelojnë shoqëri dhe fonde pensionale, në pajtim me këtë ligj;

d) lista e themeluesve dhe të dhënat për lidhjen e personave juridikë, dhe sqarimet për karakterin e asaj lidhjeje;

dh) për të gjithë personat që do të ishin themelues, kopje të vërtetuara nga aktet themeluese dhe statutet e shoqërive, dhe ekstrakti nga organi kompetent në të cilin janë regjistruar, emrat dhe adresat e anëtarëve të këshillave drejtuese, dhe kopjet e vërtetuara nga tre raportet e fundit financiare të reviduara nga revizori i jashtëm i autorizuar, si dhe çdo dëshmi plotësuese e nevojshme që të dëshmohet se janë plotësuar kushtet nga neni 26 paragrafi (1) dhe (3) i këtij ligji;

e) dokumentet me të cilat vërtetohet se në datën e paraqitjes së kërkesave, themeluesit që do të posedojnë 51% të kapitalit themelues të shoqërisë, kanë përvojë të madhe në udhëheqje me mjete dhe kanë rejting të preferueshëm për investim, sipas agjencive rejting ndërkombëtare kreditore me renome, së paku për periudhën prej një viti, para se të paraqiten si themelues;

ë) dëshmia për prejardhjen e mjeteve financiare, që do të paguhen në emër të kapitalit themelues të shoqërisë;

f) lista e kandidatëve për anëtarë të këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, bashkë me deklaratat me të cilat ata pajtohen që t'i kryejnë këto funksione nëse marrin leje për themelim, dhe t'i plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë ligj, duke përfshirë tërheqjen nga çfarëdo funksioni që paraqet konflikt të interesave dhe është i ndaluar me këtë ligj, si dhe përshkrimin e kualifikimeve të tyre profesionale dhe të përvojës së përparshme profesionale;

g) të dhënat për personat që do të jenë në vende udhëheqëse dhe personat e tjerë që propozohen të jenë përgjegjës për të gjitha vendimet investuese, revizionin e brendshëm, llogaritë individuale, marketingun dhe kontrollin e agjentëve;

gj) certifikatat se personave që janë anëtarë të organeve të udhëheqjes dhe administrimit të shoqërisë, nuk u është kumtuar sanksioni kundërvajtës, ndalim për kryerjen e funksionit, veprimtarisë ose detyrës në sferën juridike, bankare, të kontabilitetit, sigurimit, menaxhimit me mjete dhe investimit, udhëheqjes me fonde pensionale ose shërbime financiare;

h) programi për implementimin e themelimit të shoqërisë dhe fondeve pensionale, si dhe plani organizativ për strukturën e shoqërisë;

i) programet për strategjitë investuese të fondeve pensionale dhe

j) dokumente të tjera të nevojshme që i përcakton Agjencia.

(2) Në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesave nga neni 54 paragrafi (1) i këtij ligji, Agjencia mund të kërkojë dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave plotësuese.

(3) Agjencia mundet që në mënyrë plotësuese, të analizojë fakte të veçanta lidhur me kërkesat dhe dokumentacionin, dhe për atë qëllim mundet:

a) të drejtohet te organet dhe institucionet e tjera kompetente rregulluese dhe të supervizionit, në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit dhe

b) të grumbullojë dokumente dhe të dhëna nga burimet e tjera.

Neni 56

Agjencia u lëshon leje për themelimin e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, dhe leje të kushtëzuara për udhëheqje me fonde pensionale kërkuesve, në bazë të dokumenteve dhe të dhënave nga neni 55 i këtij ligji, nëse nuk është në kundërshtim me interesat e personave të cilët do të mund të anëtarësoheshin në fondet e ardhshme pensionale, që do të themelohen në bazë të këtij ligji, dhe pas plotësimit të kushteve si vijojnë:

a) dokumentet dhe të dhënat në disponim, tregojnë se personat e interesuar disponojnë me mjete financiare për atë dedikim;

b) dokumentet dhe të dhënat në disponim, tregojnë se personat e interesuar i plotësojnë kushtet për themelues, nga neni 24 dhe 25 i këtij ligji;

c) dokumentet dhe të dhënat në disponim, tregojnë se personat e propozuar për anëtarë të këshillit drejtues dhe të këshillit mbikëqyrës, dhe personat përgjegjës për udhëheqje investuese, i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj;

ç) emri i propozuar i shoqërisë së ardhshme ose emrat e fondeve pensionale, nuk do t'u shkaktojë huti anëtarëve të fondit, anëtarëve të ardhshëm ose cilitdo person tjetër, që do të mund të ketë kontakte me shoqërinë dhe fondet pensionale dhe

d) puna e shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe fondet me të cilat do të udhëheqë, do të kryhet në pajtim me standardet e udhëheqjes me fonde pensionale dhe zakonet e mira afariste.

Neni 57

(1) Agjencia merr vendim për kërkesat nga neni 54 paragrafi (1) i këtij ligji, në afat prej 60 ditësh nga pranimi i kërkesave.

(2) Personave të interesuar të cilëve u janë pranuar kërkesat, Agjencia u lëshon leje për themelimin e shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, leje të kushtëzuara për udhëheqje me fondin pensional të obligueshëm dhe leje të kushtëzuara për udhëheqje me fondin pensional vullnetar.

(3) Personat e interesuar të cilëve u është lëshuar leje për themelim dhe leje e kushtëzuara për udhëheqje me fonde pensionale, janë të obliguar që të themelojnë shoqëri, në pajtim me dokumentacionin e paraqitur, në bazë të Ligjit për shoqëri tregtare dhe të këtij ligji. Shoqëria doemos duhet të themelohet në afatin prej 90 ditësh nga pranimi i lejes, ndërsa për shkaqe të arsyeshme Agjencia mundet ta vazhdojë afatin për më së shumti 90 ditë.

(4) Nëse personat e interesuar të cilëve u është lëshuar leja për themelim, nuk themelojnë shoqëri në afatin e përcaktuar me paragrafin (3) të këtij neni, pas kalimit të atij afati Agjencia do ta heqë lejen për themelim.

Neni 58

(1) Personave të interesuar të cilëve nuk u është lëshuar leje, Agjencia u dërgon vendim me arsyetim për refuzimin. Këto vendime janë të kapshme për opinionin.

(2) Kundër vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, personi i interesuar mund të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente. Padia nuk e prolongon zbatimin e vendimit.

Neni 59

(1) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare e njofton Agjencinë për themelimin dhe regjistrimin në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, në afatin prej 30 ditësh nga regjistrimi i kryer. Shoqëria është e detyruar që të dërgojë kopjet e vërtetuara nga aktet themeluese dhe statuti i shoqërisë, versionet e fundit të dokumenteve nga neni 55 paragrafi (1) pikat (b) dhe (c) të këtij ligji, dhe dokumente të tjera lidhur me punën e fondit pensional, të përcaktuara nga Agjencia.

(2) Pas plotësimit të kushteve të parapara në nenin 57 paragrafi (3) i këtij ligji dhe paragrafi (1) nga ky nen leja e kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm dhe lejen kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional vullnetar bëhen të plotfuqishme.

(3) Shoqëria nuk mund të fillojë me aktivitetet e udhëheqjes me fondin pensional, si dhe marketingun dhe analizën e mendimit publik para marrjes së lejes për themelim, lejeve për udhëheqje me fondet pensionale, para regjistrimit në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë dhe para datës së përcaktuar nga Agjencia.

Neni 60

(1) Të gjitha ndryshimet e aksionarëve, anëtarëve të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës, personave përgjegjës ose ndryshimet dhe plotësimet e dokumenteve dhe të dhënave të shënuara në nenin 55 të këtij ligji, i nënshtrohen pëlqimit paraprak nga ana e Agjencisë, përveç nëse ndryshimet janë jashtë kontrollit të shoqërisë, ndërsa ajo i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për pengimin e atyre ndryshimeve. Për ndryshimet e shkaktuara jashtë kontrollit të shoqërisë, ajo është e detyrueshme ta njoftojë Agjencinë.

(2) Agjencia i vlerëson ndryshimet nga paragrafi (1) të këtij neni në pajtim me dispozitat për plotësimin e kushteve nga neni 56 të këtij ligji.

Neni 61

(1) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme të themeluara me Ligjin për sigurim pensional të detyrueshëm kapital financiar mund të udhëheqë dhe me fondin pensional vullnetar pas marrjes së lejes për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale vullnetare nga Agjencia, e pas ndryshimit të kryer në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, nga Agjencia, merr leje për udhëheqje me fondin pensional vullnetar.

(2) Për shkak të marrjes së lejes nga paragrafi (1) të këtij neni dhe lejes së kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional vullnetar, shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme i dërgon Agjencisë kërkesë me dokumentacionin të shënuara në nenin 39 paragrafi (1) pikat a), b), c), ë), g), h), i) dhe j) i këtij ligji, deklaratën e nënshkruar nga nënshkruarës të autorizuar të shoqërisë, nëse merr leje do të bëjë ndryshim në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë dhe do të themelojë fondin pensional vullnetar në pajtim me këtë ligj, si dhe dërgon plan afarist i cili i përmban detajet për të gjitha dëshmëpërblimet dhe provizionet që do të arkëtohen në pajtim me këtë ligj.

(3) Kërkesa nga paragrafi (2) i këtij neni, dërgohet e nënshkruar nga nënshkruarit e autorizuar të shoqërisë për udhëheqje me fondet e detyrueshme pensionale, në formën e përcaktuar nga Agjencia.

(2) Në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesave nga paragrafi (2) i këtij neni, Agjencia mund të kërkojë dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave plotësuese.

(5) Agjencia në mënyrë plotësuese mund të kontrollojë fakte të veçanta lidhur me kërkesat dhe dokumentacionin dhe për këtë qëllim mund:

a) t'u drejtohet organeve dhe institucioneve tjera kompetente rregullatore dhe të supervizionit në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit, dhe

b) të grumbullojë dokumente dhe të dhëna nga burime të tjera.

Neni 62

Agjencia u lëshon leje për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale vullnetare dhe leje me kushtëzim për udhëheqje me fondet penzionale vullnetare të shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme, në bazë të dokumenteve dhe të dhënave nga neni 61 paragrafi (2), (4) dhe (5) i këtij ligji, nëse nuk është në kundërshtim me interesat e personave të cilët do të mund të anëtarësoheshin në fondin pensional vullnetar, i cili do të themelohet në bazë të këtij ligji dhe sipas vlerësimit për plotësimin e kushteve, si vijojnë:

a) nga dokumentet dhe informatat e marra rezulton se nëse jepet leje për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, në shoqërinë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare do të paguhet kapitali themelues i përcaktuar me këtë ligj;

b) nga dokumentet dhe të dhënat në dispozicion rezulton se kërkuesi disponon me mjete financiare për atë qëllim;

c) nga dokumentet dhe të dhënat në dispozicion rezulton se kërkuesi i plotëson kushtet për themelues, nga neni 24 dhe 26 i këtij ligji;

ç) nga dokumentet dhe të dhënat në dispozicion rezulton se personat e propozuar për anëtarë të këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës dhe personat përgjegjës për udhëheqje investuese, i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj;

d) dokumentet e dërguara në pajtim me nenin 61 paragrafi (2) dhe (4) i këtij ligji, përmbajnë dispozita që nuk do t'i rrezikojnë interesat e anëtarëve të fondeve pensionale, ose në ato dokumente nuk janë lëshuar dispozita me të cilat në masë të konsiderueshme janë të mbrojtura ato interesa;

dh) kërkuesi ka dëshmuar se kanë siguruar ose do të sigurojnë lidhjen e marrëveshjeve me kohë, për kontabilitetin financiar dhe revizionin e shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare në pajtim me këtë ligj;

e) emri i propozuar i shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare ose emri i fondit pensional vullnetar, nuk do t'i sjellë në lajthitje anëtarët e fondit, anëtarët e ardhshëm ose cilitdo person tjetër, që do të mund të ketë kontakte me atë shoqëri dhe fondin pensional;

ë) puna e shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe fondet pensionale do të kryhet në pajtim me standardet e udhëheqjes me fondet pensionale dhe zakonet e mira afariste, dhe

f) nga dokumentet dhe të dhënat rezulton se shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare nuk do të kryejë veprimtari të tjera, përveç atyre për të cilat është autorizuar në bazë të këtij ligji dhe Ligjit për sigurim pensional të detyrueshëm kapital financiar dhe të cilat drejtpërdrejt janë të lidhura me udhëheqjen me fondin pensional.

Neni 63

(1) Agjencia vendos për kërkesën nga neni 61 paragrafi (2) i këtij ligji në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(2) Shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme të cilës i pranohet kërkesa, Agjencia i lëshon leje për kryerjen e veprimtarisë -udhëheqje me fondet pensionale vullnetare dhe leje të kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional vullnetar.

(3) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme të cilës i është lëshuar leje për kryerjen e veprimtarisë -udhëheqje me fonde pensionale vullnetare është e detyrueshme ta kryejë ndryshimin në pajtim me dokumentacionin e dërguar në bazë të Ligjit për shoqëri tregtare dhe këtë ligj. Shoqëria doemos duhet të kryejë ndryshim në regjistrimin në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë në afat prej 90 ditësh nga pranimi i lejes për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, ndërsa për shkaqe të arsyeshme Agjencia mund ta vazhdojë afatin më së shumti 90 ditë.

(4) Nëse shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme të cilës i është lëshuar leja për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fonde pensionale vullnetare, nuk e kryen ndryshimin në afatin e përcaktuar me paragrafin (3) të këtij neni, pas skadimit të atij afati Agjencia do t'ia marrë lejen.

Neni 64

(1) Shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme të cilës i lëshuar kërkesa për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, Agjencia i dërgon vendim me arsytim për refuzimin. Ky vendim është i kapshëm për opinionin.

(2) Kundër vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të detyrueshme mund të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente. Padia nuk e prolongon zbatimin e vendimit.

Neni 65

(1) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare e njofton Agjencinë për ndryshimin e kryer në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë në afatin prej 30 ditësh nga regjistrimi i kryer. Shoqëria është e detyruar që të paraqesë kopje të vërtetuara nga aktet themeluese dhe statutit të shoqërisë, versionet e fundit të dokumenteve nga neni 39 paragrafi (1) pikat (b) dhe (c) të këtij ligji, dhe dokumente të tjera lidhur me punën me fondin pensional të përcaktuara nga Agjencia.

(2) Pas plotësimit të kushteve të parapara në nenin 63 paragrafi (3) nga ky ligj dhe paragrafi (1) nga ky nen leja e kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional vullnetar bëhet e plotfuqishme.

(3) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare nuk mund të fillojë me aktivitetet e udhëheqjes me fondin pensional vullnetar, si dhe marketingun dhe analizën e mendimit publik, para marrjes së lejes për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, lejes për udhëheqje me fond pensional vullnetar, para ndryshimit në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë dhe para datës së përcaktuar nga Agjencia.

Neni 66

Të gjitha ndryshimet e aksionarëve, anëtarëve të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës, personave me përgjegjësi ose ndryshimet dhe plotësimet e dokumenteve dhe të dhënat e theksuara në nenin 61 paragrafi (2) i këtij ligji, i nënshtrohen lejes paraprake nga ana e Agjencisë, përveç nëse shkaktohen ndryshime të cilat shoqëria nuk mund t'i kontrollojë, ndërsa ajo i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për pengimin e atyre ndryshimeve. Agjencia i vlerëson ndryshimet e atilla në pajtim me dispozitat nga neni 62 i këtij ligji.

Neni 67

(1) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare të themeluara me këtë ligj mund të udhëheqë edhe me fondin pensional të detyrueshëm pas marrjes së lejes për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme nga Agjencia, e pas ndryshimit të kryer në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, nga Agjencia merr leje për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm.

(2) Për shkak të marrjes së lejes nga paragrafi (1) nga ky nen dhe lejes së kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm, shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare i dërgon Agjencisë kërkesë me dokumentacionin e shënuar në nenin 55 paragrafi (1) pikat a), b), c), ë), g), h), i) dhe j) të këtij neni, dokumente me të cilat vërtetohet se në datën e dërgimit të kërkesës themeluesit e shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare të cilat do të posedojnë 51% nga kapitali themelor të shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare kanë përvojë të madhe në udhëheqje me mjetet dhe kanë rejting të rekomandueshëm për investim në bazë të agjencive me renome ndërkombëtare kreditore me rejting, së paku në periudhë prej një viti para se të paraqiten si themelues, deklaratë e nënshkruar nga nënshkruar të autorizuar të shoqërisë, nëse merr leje për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme do të kryejë ndryshim në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë dhe do të themelojë fond pensional të detyrueshëm në pajtim me këtë ligj, si dhe të dërgojë plan afarist i cili do t'i përmbajë detajet për të gjitha kompensimet dhe provizionet që dë të paguhet në pajtim me këtë ligj.

(3) Kërkesa nga paragrafi (2) i këtij neni dërgohet e nënshkruar nga nënshkruar të autorizuar të shoqërisë për udhëheqje me fonde të pensionale vullnetare, në formën e përcaktuar nga Agjencia.

(4) Në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesave nga paragrafi (2) i këtij neni, Agjencia mund të kërkojë dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave plotësuese.

(5) Agjencia në mënyrë plotësuese mund të kontrollojë fakte të veçanta lidhur me kërkesat dhe dokumentacionin dhe për këtë qëllim mund:

a) t'u drejtohet organeve dhe institucioneve tjera kompetente rregullatore dhe të supervizionit në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit, dhe

b) të grumbullojë dokumente dhe të dhëna nga burime të tjera.

Neni 68

Agjencia u lëshon leje për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe leje me kushtëzim për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme të shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, në bazë të dokumenteve dhe të dhënave nga neni 67 paragrafi (2), (4) dhe (5) i këtij ligji, nëse nuk është në kundërshtim me interesat e personave të cilët do të mund të anëtarësoheshin në fondin pensional të detyrueshëm, i cili do të themelohet në bazë të këtij ligji dhe sipas vlerësimit për plotësimin e kushteve, si vijojnë:

a) nga dokumentet dhe informatat e marra rezulton se nëse jepet leje për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, në shoqërinë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare do të paguhet kapitali themelues i përcaktuar me këtë ligj;

b) nga dokumentet dhe të dhënat në dispozicion rezulton se kërkuarësi disponon me mjete financiare për atë qëllim;

c) nga dokumentet dhe të dhënat në dispozicion rezulton se kërkuarësi i plotëson kushtet për themelues, nga neni 24 dhe 26 i këtij ligji;

ç) nga dokumentet dhe të dhënat në dispozicion rezulton se personat e propozuar për anëtarë të këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës dhe personat përgjegjës për udhëheqje investuese, i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj;

d) dokumentet e paraqitura në pajtim me nenin 67 paragrafi (2) dhe (4) të këtij ligji përmbajnë dispozita që nuk do t'i rrezikojnë interesat e anëtarëve të fondeve pensionale, ose në ato dokumente nuk janë lëshuar dispozita me të cilat në masë të konsiderueshme janë të mbrojtura ato interesa;

dh) kërkuarësi ka dëshmuar se kanë siguruar ose do të sigurojnë lidhjen e marrëveshjeve me kohë për kontabilitetin financiar dhe revizionin e shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare në pajtim me këtë ligj;

e) emri i propozuar i shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare ose emri i fondit pensional të detyrueshëm, nuk do t'i sjellë në lajthitje anëtarët e fondit, anëtarët e ardhshëm ose cili do person tjetër, që do të mund të ketë kontakte me atë shoqëri dhe fondin pensional;

ë) puna e shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe fondeve pensionale do të kryhet në pajtim me standardet e udhëheqjes me fondet pensionale dhe zakonet e mira afariste, dhe

f) nga dokumentet dhe të dhënat rezulton se shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare nuk do të kryejë veprimtari të tjera, përveç atyre për të cilat është autorizuar në bazë të këtij ligji dhe Ligjit për sigurim pensional të detyrueshëm kapital financiar dhe të cilat drejtpërsëdrejti janë të lidhura me udhëheqje me fondet pensionale.

Neni 69

(1) Agjencia merr vendim për kërkesën nga neni 67 paragrafi (2) i këtij ligji në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(2) Shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare të cilës i pranohet kërkesa, Agjencia i lëshon leje për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe leje të kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm .

(3) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare të cilës i është lëshuar leje për kryerjen e veprimtarisë -udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme është e detyrueshme ta kryejë ndryshimin në pajtim me dokumentacionin e dërguar në bazë të Ligjit për shoqëri tregtare dhe këtë ligj. Shoqëria doemos duhet ta bëjë reregjistrimin në Regjistrin qendror në afat prej 90 ditësh nga pranimi i lejes për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale vullnetare, e për shkaqe të arsyeshme Agjencia mundet ta vazhdojë afatin për më së shumti 90 ditë.

(4) Nëse shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare të cilës i është lëshuar leja për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fonde pensionale të detyrueshme, nuk e kryen ndryshimin në afatin e përcaktuar me paragrafin (3) nga ky nen, pas skadimit të atij afati Agjencia do t'ua marrë lejen.

Neni 70

(1) Shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare të cilës nuk është lëshuar leja për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme, Agjencia i dërgon vendim me arsyetim për refuzimin. Vendimi është i kapshëm për publikun.

(2) Kundër vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare mund të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente. Padia nuk e prolongon zbatimin e vendimit.

Neni 71

(1) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare e njofton Agjencinë për ndryshimin e kryer në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, në afatin prej 30 ditësh nga regjistrimi i kryer. Shoqëria është e detyruar që të dorëzojë kopjet e vërtetuara nga aktet themeluese dhe statutin e shoqërisë, versionet e fundit të dokumenteve nga neni 55 paragrafi (1) pikat (b) dhe (c) të këtij ligji, dhe dokumentet e tjera të lidhura me punën e fondit pensional të përcaktuara nga Agjencia.

(2) Pas plotësimit të kushteve të parapara në nenin 69 paragrafi (3) nga ky ligj dhe paragrafi (1) të këtij neni leja e kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional bëhet e plotfuqishme.

(3) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare nuk mund të fillojë me aktivitetet e udhëheqjes me fondin pensional të detyrueshëm, si dhe marketingun dhe analizën e mendimit publik, para marrjes së lejes për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me

fondet pensionale të detyrueshme, lejen për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm, para regjistrimit në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë dhe para datës së përcaktuar nga Agjencia.

Neni 72

Të gjitha ndryshimet e aksionarëve, anëtarët e këshillit drejtues dhe mbikëqyrës, personat me përgjegjësi ose ndryshimet dhe plotësimet e dokumenteve dhe të dhënave të theksuara në nenin 67 paragrafi (2) dhe (4) i këtij ligji, i nënshtrohen lejes paraprake nga ana e Agjencisë, përveç nëse shkaktohen ndryshime të cilat shoqëria nuk mund t'i kontrollojë, ndërsa ajo i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për pengimin e atyre ndryshimeve. Agjencia i vlerëson ndryshimet e atilla në pajtim me dispozitat nga neni 68 i këtij ligji.

Neni 73

Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare pas ndryshimit të kryer në nenin 61 paragrafi (1) dhe 67 paragrafi (1) i njofton anëtarët e fondeve të tyre për ndryshimin e kryer.

Neni 74

Agjencia për së afërmi e përcakton mënyrën e marrjes së lejes për themelim, lejes për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqjen me fondet pensionale vullnetare, lejes për kryerjen e veprimtarisë - udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe lejes për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar.

Neni 75

(1) Fondi pensional vullnetar me të cilin udhëheq shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare doemos duhet të jetë i ndarë nga fondi pensional i detyrueshëm me të cilin udhëheq ajo shoqëri.

(2) Agjencia për së afërmi e përcakton mënyrën e udhëheqjes së ndarë të evidencës për fondin pensional vullnetar dhe të detyrueshëm të udhëhequr nga shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare si dhe masat e nevojshme për ndarjen financiare të fondit pensional të detyrueshëm nga fondi pensional i vullnetar.

Neni 76

(1) Agjencia mund të tërheqë ose anulojë lejen për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar të shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare nga shkaqet e njëjta për shka të së cilave refuzon kërkesën në pajtim me nenin 55, 61 paragrafi (2) dhe 67 paragrafi (2) i këtij ligji, pas ndodhjes së kushteve nga neni 23 paragrafi (7) i këtij ligji, për shkak të mosplotësimit të kushteve për marrjen e lejes nga neni 62 dhe 68 i këtij ligji, keqpërdorimit të të dhënave publike, në raste tjera të shkeljes së vrazhdtë të dispozitave nga ky ligj dhe me kërkesë të shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.

(2) Para se ta tërheqë ose ndërpresë lejen për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar, Agjencia shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare do t'i japë mundësi që t'i evitojë paligjshmëritë dhe parregullsitë në punë, në afatin e përcaktuar nga Agjencia, përveç nëse konsideron se mundësia e atillë do të ishte në kundërshtim me interesat e anëtarëve të fondit pensional dhe/ose vullnetar, ose interesit publik.

(3) Agjencia menjëherë e njofton shoqërinë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare për vendimin e tërheqjes ose anulimit të lejes për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar.

(4) Kundër vendimit të Agjencisë nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëria për udhëheqje me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare mund të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente. Padia nuk e prolongon zbatimin e vendimit.

(5) Agjencia për së afërmi e përcakton mënyrën e tërheqjen ose anulimit të lejes për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar nga paragrafi (1) nga ky nen.

Neni 77

(1) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare të cilës i është tërhequr leja për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar në bazë të nenit 76 të këtij ligji, vazhdon të punojë nën mbikëqyrjen e Agjencisë, në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia, pas pajtimit paraprak nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(2) Nëse shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare i anulohet leja për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe/ose vullnetare, në bazë të nenit 76 të këtij ligji për shkak të mbrojtjes së interesave të anëtarëve të fondeve pensionale, Agjencia e ndërmerr administrimin dhe udhëheqjen me atë fond pensional deri përfundimin e vendimit për anulimin e lejes, në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia pas pajtimit paraprak nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(3) Kur vendimi për anulimin e lejes për udhëheqje me fondin pensional vullnetar do të jetë përfundimtare, Agjencia i shpërndan anëtarët e fondeve pensionale vullnetare me zgjedhje të rastësishme në mënyrë të përcaktuar me ligj nga Agjencia. Nëse nuk ka asnjë fond pensional vullnetar Agjencia udhëheq me fondin pensional me të cilën ka udhëhequr shoqëria të cilës i është anuluar leja për udhëheqje me fondin pensional vullnetar.

(4) Gjatë shpërndarjes së anëtarëve në fondet pensionale vullnetare, në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, Agjencia siguron që numri i të siguruarve që sistemohet në secilin fond pensional vullnetar, të caktohet sipas pagesës së fondit pensional dhe lartësisë së kompensimit nga neni 117 paragrafi (1) pika a) e këtij ligji, që e paguan shoqëria që udhëheq me atë fond pensional, në datën që e përcakton Agjencia.

(5) Kur vendimi për anulimin e lejes për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm do të jetë përfundimtare, Agjencia i sistemon anëtarët në fondet pensionale të detyrueshme ekzistuese me zgjedhje të rastësishme në mënyrë të përcaktuar me ligj nga Agjencia. Nëse ka së paku dy fonde pensionale të detyrueshme Agjencia administron me fondin pensional me të cilin ka udhëhequr shoqëria të cilës i është anuluar leja për udhëheqje me fondin pensional vullnetar.

(6) Gjatë shpërndarjes së anëtarëve në fondet pensionale vullnetare, në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni, Agjencia siguron që numri i të siguruarve që sistemohet në secilin fond pensional vullnetar, të caktohet sipas të ardhurave të fondit pensional dhe lartësisë së kompensimit nga neni 95 paragrafi (1) pika a) nga ligji për sigurim pensional të detyrueshëm kapital vullnetar, që e paguan shoqëria që udhëheq me atë fond pensional, në datën që e përcakton Agjencia.

Neni 78

Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, mund të lidhet vetëm me shoqëri tjetër për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.

Neni 79

(1) Me bashkimin e shoqërive nga neni 78 të këtij ligji themelohet shoqëri e re.

(2) Shoqëria e re themelohet në bazë të lejes së lëshuar nga Agjencia, e pas themelimit, nga agjencia merr leje për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm dhe leje për udhëheqje me fondin pensional vullnetar.

(3) Për shkak të marrjes së lejes për themelimin e shoqërisë së re me udhëheqje të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, shoqëritë ekzistuese i paraqesin Agjencisë kërkesë me dokumentacionin e shënuar në nenin (5) të këtij ligji, dhe planin afarist që i përmban hollësitë

për të gjitha kompensimet dhe provizionet që do të paguhen në pajtim me këtë ligj. Kërkesat për lejet për udhëheqje me fondin pensional të detyrueshëm dhe vullnetar, dërgohen bashkë me kërkesën për leje për themelimin e shoqërisë.

(4) Kërkesat nga paragrafi (2) i këtij neni, dërgohen të nënshkruara nga nënshkruesit e autorizuar të shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, të cilët do të ishin themeluesit e shoqërisë së re, në formën e përcaktuar nga Agjencia.

(5) Ndaj kërkesave nga paragrafi (3) i këtij neni, shoqëritë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare duhet doemos t'i paraqesin dokumentet, si vijojnë:

- a) Vendimin për bashkëngjitjen e marrë nga organi kompetent i secilës nga shoqëritë;
- b) Marrëveshjen për bashkëngjitje të shoqërive;
- c) Planin organizativ dhe financiar për implementimin e shoqërisë së re;
- ç) Emërtimin e shoqërisë së re dhe fondeve të reja pensionale;
- d) Informacionet për atë se vallë aksionarët janë persona të ndërlidhur;
- dh) Dokumentet për gjendjen financiare të aksionarëve të secilës shoqëri, për të gjitha vitet nga themelimi i saj dhe më së shumti për periudhën prej pesë vjetësh i cili i paraprin datës së dorëzimit të kërkesës, duke përfshirë dhe dokumentet me të cilat vërtetohet se asnjë prej aksionarëve nuk ka tatime me vonesë të papaguara dhe kontribute për sigurim social;
- e) Prospektet e reviduara informative për fondet e reja pensionale ;
- ë) Projektstatutin e fondeve të reja pensionale në të cilën theksohen kompensimet e planifikuara;
- f) Projekt-marrëveshjen me ruajtësin e pronës për fondet e reja pensionale dhe detaje për prishjen e marrëveshjeve ekzistuese;
- g) Emrat e anëtarëve të propozuar në këshillit administrativë dhe mbikëqyrës dhe nëse këta persona nuk janë pjesë nga shoqëritë të cilat bashkohen dhe informacionet nga neni 55 paragrafi (1) pika f) e këtij ligji;

gj) Të dhënat për personat që do të jenë në vende udhëheqëse dhe personat e tjerë që propozohen të jenë përgjegjës për vendimet investuese, revizionin e brendshëm, llogaritë individuale, marketingun dhe kontrollin e agjentëve;

- h) Programin për strategjinë investuese të fondeve të reja pensionale; dhe
- i) Dokumentet e tjera që i përcakton Agjencia.

(6) Agjencia lëshon leje për themelimin e shoqërisë së re për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe leje për udhëheqje me fondin pensional vullnetar në bazë të dokumenteve nga paragrafi (5) të këtij neni dhe pas plotësimit të kushteve nga ky ligj.

(7) Shoqëria e re për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare është trashëgimtare juridike e të dyja shoqërive për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare të cilat e kanë themeluar.

(8) Agjencia për së afërmi e përcakton mënyrën e bashkimit të shoqërive nga neni 78 i këtij ligji dhe bashkimin e fondeve pensionale nga neni 81 paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 80

Agjencia mund ta refuzojë kërkesën për bashkimin e shoqërive për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, nëse:

- a) Kërkesa me dokumentacionin nuk i plotësojnë kushtet e këtij ligji;
- b) Dokumentet e bashkangjitura ndaj kërkesës ose informatat tjera tregojnë se cilado prej shoqërive që bashkohet në periudhën prej pesë vjetësh para dërgimit të kërkesës ka borxhe të mbetura në bazë të tatimeve dhe kontributeve të papaguara për sigurim social;
- c) Aksionet e cilësdo shoqëri e kanë origjinën nga huamarrja, kreditë ose janë të ngarkuara në çfarëdo mënyre;
- ç) Aktivitetet afariste të bartësve të kërkesës nuk garantojnë se shoqëria e re dhe fondet pensionale me të cilin do të udhëheq do të udhëhiqen në interesin më të mirë të anëtarëve; dhe

d) Me bashkimin rrezikohen interesat e anëtarëve të fondeve pensionale ose interesit tjetër publik.

Neni 81

(1) Fondet pensionale vullnetare bashkohen në të njëjtën kohë me shoqëritë të cilat kanë udhëhequr me ato fonde pensionale dhe themelohet një fond pesional vullnetar.

(2) Fondet pensionale të detyrueshme bashkohen në të njëjtën kohë me shoqëritë të cilat kanë udhëhequr me ato fonde pensionale dhe themelohet një fond pesional i detyrueshëm.

(3) Pas bashkimit të fondeve pensionale nga paragrafi (1) dhe (2) i këtij neni, fondet pensionale i marrin të drejtat dhe detyrimet nga fondet pensionale të cilat janë bashkuar.

Neni 82

Para bashkimit të shoqërive nga neni 78 i këtij ligji, shoqëritë në formë të shkruar i njoftojnë të gjithë anëtarët dhe siguruesit për vendimin e bashkimit. Pas bashkimit, shoqëria e re për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare në formë të shkruar i njofton të gjithë anëtarët dhe siguruesit për emërtimin e shoqërisë së re, emërtimet e fondeve të reja pensionale dhe i dorëzon kopje nga prospekti informativ, statutet e shoqërisë së re dhe statutet e fondeve të reja pensionale, prospektin informativ, statutin e shoqërisë së re dhe statutet e fondeve të reja pensionale.

Neni 83

(1) Shoqëritë për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, mund të bashkohen vetëm me shoqëri tjetër për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.

(2) Në rast të bashkimit të njëres shoqëri me tjetrën nga paragrafi (1) i këtij neni, fondi pesional vullnetar me të cilin udhëheq shoqëria e cila bashkohet me shoqërinë e cila bashkohet me fondin pesional vullnetar me të cilin udhëheq shoqëria ndaj së cilës kryhet bashkimi. Fondi pesional i detyrueshëm me të cilin udhëheq shoqëria e cila bashkohet, bashkohet me fondin pesional të detyrueshëm me të cilin udhëheq shoqëria me të cilën bëhet bashkimi.

(3) Para bashkimit të fondeve pensionale nga paragrafi (2) i këtij neni, shoqëritë me të cilën bëhet bashkimi në formë të shkruar i njofton të gjithë anëtarët dhe siguruesit.

(4) Me bashkimin e njërit fond pesional me fondin tjetër pesional anëtarët, llogaritë vullnetare individuale dhe llogaritë profesionale nga fondi pesional i cili bashkohet barten në fondin pesional me të cilin bashkohet. Me bashkimin e njërit fond pesional me tjetrin fond pesional anëtarët, llogaritë vullnetare individuale dhe llogaritë profesionale nga fondi pesional i cili bashkohet barten në fondin pesional me të cilin bashkohet.

(5) Agjencia e përcakton mënyrën e bashkimit të shoqërive dhe fondeve pensionale nga ky nen.

KREU 6 SKEMAT PROFESIONALE PENSIONALE

Neni 84

(1) Punëdhënësi ose shoqata e qytetarëve mund të organizojë dhe financojë skemë pensionale profesionale vetëm për të punësuarit ose anëtarët e vet.

(2) Më tepër punëdhënës ose më tepër shoqata të qytetarëve së bashku mund të organizojnë dhe financojnë skema pensionale profesionale.

(3) Siguruesi nënshkruan marrëveshje për organizimin dhe financimin e skemës pensionale profesionale me përfaqësuesit e të punësuarëve ose anëtarëve të vet.

(4) Siguruesi nënshkruan marrëveshje me shoqërinë të cilën e ka zgjedhur të udhëheqë me fondin pesional vullnetar në të cilin do të përfshihet skema pensionale profesionale.

(5) Siguruesi miraton rregulla për skemën pensionale profesionale. Rregullat për skemën pensionale profesionale detyrimisht përmbajnë:

- a) emrin e skemës pensionale profesionale;
- b) emërtimin e fondit pensional vullnetar në të cilin është përfshirë skema pensionale profesionale dhe emërtimin e shoqërisë e cila udhëheq me atë fond pensional;
- c) kontributin të cilin siguruesi do ta paguajë për skemën pensionale profesionale në emër të punësuarve ose anëtarëve të përllogaritur si përqindje e pagës;
- ç) kushtet për fitimin e të drejtës për pjesëmarrje në skemën pensionale profesionale, në pajtim me këtë ligj;
- d) të dhënat në detaje për kompensimet nga neni 117 paragrafi (1) i këtij ligji; dhe
- dh) informacionet për të drejtat për kalim dhe të drejtat e kompensimit pensional.

Neni 85

(1) Siguruesi paguan kontribute për çdo pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale të cilën ai e organizon dhe financon.

(2) Siguruesi mund ta anulojë skemën pensionale profesionale ose ta ndryshojë fondin pensional vullnetar ku është përfshirë skema pensionale profesionale.

(3) Nëse siguruesi ndërmerr ndonjë prej aktiviteteve nga paragrafi (2) të këtij neni, është i detyruar që paraprakisht në afat prej 30 ditësh në formë të shkruar t'i njoftojë të gjithë pjesëmarrësit në skemën pensionale profesionale.

Neni 86

(1) Siguruesi mund të përcaktojë se cilët punëtorë ose anëtarë mund të marrin pjesë në skemën pensionale profesionale dhe ta përcaktojë shkallën e kontributit të cilën do ta paguajë për çdonjërin nga ata.

(2) Shoqata e qytetarëve e cila ka organizuar skemën pensionale profesionale mund të përcaktojë se anëtari i saj mund të marrë pjesë në skemën pensionale profesionale vetëm nëse anëtari financiarisht merr pjesë në mbulimin e shpenzimeve të shoqatës lidhur me skemën pensionale profesionale.

Neni 87

Një sigurues mund të organizojë vetëm një skemë pensionale profesionale.

Neni 88

Çdo person, në afat prej 15 ditësh nga hyrja në marrëdhënie pune te punëdhënësi i cili ka organizuar skemën pensionale profesionale, ka të drejtë në kopje nga rregullat e skemës pensionale profesionale, statutin e fondit pensional në të cilin është e përfshirë edhe skema, pa marrë parasysh atë se në momentit e punësimit ka të drejtë të anëtarësohet në skemën pensionale profesionale.

Neni 89

Siguruesi është i detyruar t'i paguajë nga mjetet e veta kompensimet nga neni 117 paragrafi (1) pika (a) dhe (c) të këtij ligji, për anëtarët e fondit pensional të cilët marrin pjesë në skemën e tij pensionale profesionale.

Neni 90

(1) Siguruesi është i detyruar që zgjedhjen e fondit pensional vullnetar ta bëjë në interes më të mirë të punësuarve ose anëtarëve të tij.

(2) Siguruesi nuk mund të vendosë asnjë mekanizëm për kufizimin e të drejtave të fitimit të kompensimit pensional për anëtarët të cilët marrin pjesë në skemën e tij pensionale profesionale.

Neni 91

(1) Çdo pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale nënshkruan deklaratë për pajtueshmëri për pjesëmarrje në skemën pensionale profesionale dhe ia dërgon siguruesit.

(2) Pas nënshkrimit të marrëveshjes nga neni 84 paragrafi (4) i këtij ligji siguruesi ia dërgon shoqërisë listën e pjesëmarrësve në skemën e tij pensionale profesionale . Siguruesi rregullisht e njofton shoqërinë për çdo ndryshim të listës.

(3) Personat të cilat bëhen anëtarë të fondit pensional vullnetar në bazë të skemës pensionale profesionale marrin vërtetime për anëtarësim nga shoqëria në afat prej 30 ditësh nga anëtarësimi dhe nuk lidhin marrëveshje me shoqërinë e cila udhëheq me fondin pensional vullnetar.

(4) Agjencia e përcakton formën e standardizuar të deklaratës për pajtueshmëri në skemën pensionale profesionale dhe të vërtetimit për anëtarësim nga paragrafi (1) dhe (3) të këtij neni.

(5) Anëtari i fondit pensional vullnetar në bazë të skemës pensionale vullnetare i ka të njëjtat drejta si dhe anëtari në bazë të marrëveshjes për anëtarësim të lidhur me shoqërinë, përveç të drejtës që të paguajë kontributet.

(6) Shoqëria nuk mund të kufizojë ose refuzojë të drejtën e anëtarit të fondit pensional në bazë të skemës pensionale profesionale nëse ai anëtar nuk ka marrëveshje për anëtarësim me shoqërinë.

Neni 92

(1) Pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale, të cilit i ka pushuar marrëdhënia e punës te punëdhënësi ose anëtarësia në shoqatën e qytetarëve e cila është organizatore e skemës pensionale profesionale, ka të drejtë që me zgjedhje personale në afat prej 90 ditësh të kërkojë bartjen e shumës së përgjithshme të mjeteve në llogarinë e tij profesionale.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, kur anëtari do të kalon te siguruesi tjetër, mjetet e tij nga llogaria ekzistuese profesionale barten në llogarinë profesionale në skemën pensionale profesionale të organizuar nga siguruesi tjetër.

(3) Nëse anëtari i fondit pensional punësohet te punëdhënësi ose bëhet anëtar i shoqatës së qytetarëve e cila nuk ka skemë pensionale profesionale, mjetet nga llogaria profesionale të anëtarit barten në llogarinë e tij vullnetare individuale. Nëse anëtari i fondit pensional punësohet te punëdhënësi ose bëhet anëtar i shoqatës së qytetarëve e cila ka skemë pensionale profesionale, por nuk është pjesëmarrës në skemën, mjetet nga llogaria profesionale i anëtarit barten në llogarinë e tij vullnetare individuale. Kur anëtari nuk ka llogari vullnetare individuale doemos duhet të lidhë marrëveshje për anëtarësim me fondin pensional vullnetar dhe të kërkojë nga shoqëria e cila e mban llogarinë e tij profesionale të mjeteve nga ajo llogari në llogarinë vullnetare individuale.

(4) Nëse anëtari i fondit pensional nuk kërkon bartje të mjeteve nga llogaria e përhershme profesionale në afatin e paraparë në paragrafin (1) nga ky nen, shoqëria e cila e mban llogarinë do të kërkojë informacion nga Agjencia se anëtari ka llogari vullnetare individuale. Nëse nuk ka, shoqëria i hap llogari vullnetare individuale anëtarit në fondin vullnetar pensional me të cilën udhëheq dhe i dërgon vërtetim për anëtarësim. Shoqëria i bart mjetet nga llogaria e përhershme ekzistuese profesionale në llogarinë vullnetare individuale.

(5) Agjencia e përcakton kohën dhe mënyrën për bartjen e mjeteve në pajtim me këtë nen.

Neni 93

(1) Nëse dy sigurues bashkohen ose bashkëngjiten, siguruesi i vetëm i cili do të dalë nga ai proces, në afat prej 180 ditësh nga data e bashkimit ose bashkëngjitjes doemos duhet të organizojë skemë pensionale profesionale të vetme për të punësuarit dhe anëtarët e tij.

(2) Agjencia e përcakton mënyrën e bashkimit ose bashkëngjitjes së skemave pensionale profesionale .

KREU 7
ANËTARËSIMI NË FONDIN PENSIONAL VULLNETAR DHE PAGIMI I
KONTRIBUTEVE

Neni 94

(1) Anëtar i fondit pensional vullnetar mund të jetë çdo person i cili ka mbushur së paku tetëmbëdhjetë vjet moshë dhe është pronar i llogarisë vullnetare individuale apo çdo person i cili është pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale dhe është pronar i llogarisë profesionale.

(2) Personi nga paragrafi (1) i këtij ligji bëhet anëtar në fondin pensional vullnetar me nënshkrimin e marrëveshjes për anëtarësim me shoqërinë e cila udhëheq me atë fond pensional vullnetar dhe me hapjen e llogarisë vullnetare individuale ose me hapjen e llogarisë profesionale.

(3) Shoqëria nuk guxon të refuzojë anëtarësimin e personit në fondin pensional vullnetar me të cilin udhëheq nëse së paku ka mbushur 18 vjet dhe është në moshë më së shumti 70 vjeç, përveç personave nga neni 95 paragrafi (6) i këtij ligji.

(4) Agjencia e përcakton formën e standardizuar të marrëveshjes për anëtarësim nga paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Agjencia më afërsisht e rregullon mënyrën e anëtarësimit në fondin pensional vullnetar nga ky nen.

Neni 95

(1) Për personat të cilët kanë nënshkruar marrëveshje për anëtarësim shoqëria hap llogari vullnetare individuale, ndërsa për personat të cilët janë në skemën pensionale profesionale shoqëria hap llogari profesionale, menjëherë pas pagimit të parë të kontributit.

(2) Një person mund të ketë vetëm një llogari vullnetare individuale dhe një llogari profesionale. Nëse një person është i punësuar dhe/ose është anëtar te më tepër sigurues mund të ketë vetëm një llogari profesionale sipas zgjedhjes individuale.

(3) Një person mund të ketë llogari vullnetare individuale dhe llogari profesionale në të njëjtin fond pensional vullnetar ose të ndryshëm.

(4) Vetëm siguruesi mund të paguajë kontribute në llogari profesionale, e nuk mund të paguajë kontribut në llogari vullnetare individuale.

(5) Person tjetër fizik mund të paguajë kontribut në llogarinë vullnetare individuale të anëtarit në fondin pensional, në bazë të marrëveshjes së nënshkruar për anëtarësim nga ana e anëtarit, personit fizik dhe shoqërisë.

(6) Pagesat në fondin pensional vullnetar nuk guxojnë të bëhen në emër dhe për llogari të personit i cili ka realizuar të drejtën e pensionit të pleqërisë ose invalidor në pajtueshmëri me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor ose tërheq mjete në pajtim me Ligjin për sigurim pensional të detyrueshëm kapital financiar.

(7) Pagesa në fondin pensional vullnetar nuk mund të bëhen në emër dhe në llogari të personit i cili ka mbushur moshën 70 vjeç.

Neni 96

(1) Anëtari i fondit pensional vullnetar mund të kalojë dhe të anëtarësohet në fond tjetër pensional vullnetar.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) nga ky nen, anëtari i fondit pensional vullnetar si pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale nuk guxon të kalojë në fond tjetër pensional vullnetar në periudhën përderisa është i punësuar ose është anëtar i siguruesit.

(3) Anëtari i cili ka llogari vullnetare individuale në fondin pensional vullnetar (fondi i ekzistues pensional vullnetar) mund të bëhet anëtar i fondit pensional vullnetar i udhëhequr nga shoqëri tjetër (fondi i ardhshëm pensional vullnetar), me nënshkrimin e marrëveshjes për

anëtarësim me shoqërinë e cila udhëheq me fondin ardhshëm pensional vullnetar, nënshkrimin e formularit për pajtueshmëri për kalim dhe pagim të kompensimit në pajtim me nenin 117 paragrafi (1) pika c) e këtij ligji.

(4) Agjencia e përcakton mënyrën e kalimit nga një fond në fond tjetër pensional vullnetar dhe formularin për pajtueshmëri për kalim.

Neni 97

(1) Në rast të kalimit të anëtarit nga njëri në tjetrin fond pensional në pajtim me nenin 96 i këtij ligji, mjetet e atij neni barten nga fondi pensional ekzistues në atë të ardhshëm në datën e parë të ardhshme të bartjes.

(2) Agjencia për së afërmi e rregullon mënyrën dhe datat e bartjes së mjeteve ndërmjet fondeve pensionale me të cilat udhëheqin shoqëri të ndryshme dhe lloji i të dhënave që dërgohen.

Neni 98

Shoqëritë janë të detyruara të ndërmarrin masa dhe aktivitete në pajtim me Ligjin për pengimin e pastrimit të parave dhe të ardhurave tjera nga veprat ndëshkuese.

Neni 99

Nëse anëtari i fondit pensional vullnetar i cili posedon llogari vullnetare individuale ndërpret pagesën e kontributeve në fondin pensional vullnetar para pensionimit, ai mbetet të jetë anëtar i fondit pensional deri në vdekje, deri në kalimin në fond tjetër ose deri në realizimin e të drejtës së kompensimit pensional dhe i ka të gjitha të drejtat si anëtarët e tjerë të atij fondi në pajtim me këtë ligj.

Neni 100

Agjencia e përcakton mënyrën e pagimit të kontributeve në fondet pensionale vullnetare.

Neni 101

(1) Mjetet nga llogaria e anëtarit të fondit pensional vullnetar janë pjesë e pronës së tij personale.

(2) Mjetet nga llogaria e anëtarit të fondit pensional vullnetar nuk guxojnë të shfrytëzohen në procedurë të barazimit ose falimentimit.

(3) Mjetet nga llogaria e anëtarit të fondit pensional vullnetar nuk mund të jepen si peng, lejohen ose të barten në dobi të personave të tretë, përveç kur ajo është prerazi e lejuar me këtë ligj.

(4) Veprat juridike në lidhje me paragrafin (2) dhe (3) nga ky nen janë të pavlefshëm.

KREU 8

ANËTARËSIMI NDËRKUFITAR NË FONDIN PENSIONAL VULLNETAR

Neni 102

(1) Siguruesi me seli në territorin e shtetit tjetër anëtar i Unionit Evropian mund të organizojë skemë pensionale profesionale e cila do të përfshihet në fondin pensional vullnetar me të cilin udhëheq shoqëria me seli në Republikën e Maqedonisë.

(2) Shoqëria e cila do të pranojë skemën pensionale profesionale të organizuar dhe të financuar nga sigurues selia e së cilës gjendet në territorin e vendit tjetër anëtar të Unionit Evropian e njofton Agjencinë për qëllimin e tij.

(3) Njoftimi drejtuar Agjencisë nga paragrafi (2) pika e këtij neni duhet të përmbajë:

a) emrin e siguruesit të propozuar;

- b) karakteristikat kryesore të skemës pensionale profesionale; dhe
- c) të dhënat për vendin anëtar në të cilin gjendet selia e siguruesit.

Neni 103

Pas marrjes së njoftimit nga neni 102 paragrafi 92) i këtij ligji Agjencia, në afat prej 180 ditësh nga pranimi i të gjitha informacioneve, ia dërgon informacionet organeve kompetente të vendit anëtar në të cilin siguroesi i propozuar ka selinë dhe në mënyrë përkatëse e informon shoqërinë, përveç nëse ekziston dyshimi se vallë struktura administrative, gjendja financiare e shoqërisë, reputacioni i tij dhe kualifikimet profesionale ose përvoja e personave të cilët udhëheqin me shoqërinë i plotësojnë kushtet e vendit anëtar të Unionit Evropian.

Neni 104

(1) Shoqëria mund ta fusë në fondin pensional skemën pensionale profesionale të siguruesit nga vendi tjetër anëtar të Unionit Evropian pas marrjes së informacionit nga Agjencia të pranuar nga organet kompetente të vendit anëtar në të cilin ndodhet selia e siguruesit potencial se janë të plotësuara kushtet nga ligjet relevante për skemën pensionale profesionale në vendin anëtar.

(2) Agjencia e përcakton mënyrën e përfshirjes në skemën pensionale profesionale të organizuar dhe të financuar nga siguroesi selia e së cilës gjendet në territorin e vendit tjetër anëtar të Unionit Evropian, në fondin pensional vullnetar.

Neni 105

Siguroesi me seli në Republikën e Maqedonisë mund t'ia besojë udhëheqjen me skemën pensionale profesionale të tij shoqërisë së autorizuar të udhëheqë me skemat pensionale profesionale në vend tjetër anëtar të Unionit Evropian, në pajtim me ligjet nga sfera e punës, sigurimit social në Republikën e Maqedonisë dhe këtë ligj.

KREU 9

MARKETINGU I FONDIT PENSIONAL VULLNETAR

Neni 106

(1) Askush nuk guxon personit tjetër të ofrojë çfarëdo dhuratash me qëllim që ta bindë të anëtarësohet në ndonjë fond pensional vullnetar ose të bëhet anëtar në ndonjë fond pensional vullnetar ose të bëhet anëtar në ndonjë fond pensional vullnetar, si dhe të marrë pjesë në skemën pensionale profesionale ose të mbesë në skemën pensionale profesionale.

(2) Askush nuk guxon personit tjetër t'i ofrojë çfarëdo lloji dhuratash me qëllim që ta bindë të marrë pjesë ose të qëndrojë në vende ku kryhet marketingu i fondit pensional vullnetar.

(3) Askush nuk guxon të ofrojë çfarëdo lloji dhuratash të siguruesit ose me ta persona të lidhur, me qëllim që ta nxisë ose shpërblejë të bëhet organizator i skemës pensionale profesionale në ndonjë fond vullnetar ose t'iu imponojë punësuarve ose anëtarëve të vet të marrin pjesë në ndonjë skemë pensionale profesionale.

(4) Askush nuk guxon t'i ofrojë çfarëdo lloj dhuratash sindikatës ose organizatës tjetër, trupit kolektiv ose të personave të lidhur me atë organizate ose trupi, me qëllim që ta nxisë ose shpërblejë nëse i bind ose i urdhëron anëtarët e tij që të anëtarësohen në ndonjë fond pensional vullnetar.

(5) Dhuratë në kuptimin e këtij neni nënkupton, por nuk kufizohet në shpërblim parash, pagimin në kompensim në të holla për ndërprerjen e parakohshme të anëtarësimit në fondet tjera pensionale vullnetare, shpërblimin e pasurive të tundshme dhe të patundshme, kartela pagesore ose shërbime të ngjashme financiare, vepra artistike, organizimin e ekspozitave ose shfaqjeve, ose bërje të tjera të cilat zakonisht doemos duhet të paguhen, përveç atyre pagesave të cilat drejtpërdrejt dalin nga anëtarësimi në fondin pensional vullnetar.

Neni 107

(1) Personat nga paragrafi (3) i këtij neni nuk guxojnë të japin informacione të gabueshme dhe të pasakta për fondin pensional vullnetar, skemën pensionale profesionale ose për shoqërinë e cila udhëheq me atë fond ose informacione të cilat mund t'i sjellin në hamendje anëtarët e fondit pensional vullnetar, personat të cilët kanë të drejtë të bëhen anëtarë të fondit pensional vullnetar, personat të cilët në të ardhmen do të kishin të drejtë të bëhen anëtarë të fondit pensional vullnetar, siguruesit dhe siguruesit potencialë, dhe pa deklarata gojore, material të shkruar, përmes shpalljeve dhe çfarëdo materiali tjetër reklamues.

(2) Personat nga paragrafi (3) i këtij neni nuk guxojnë të japin asnjë deklaratë ose parashikime për rezultatet e ardhshme investuese të fondit pensional vullnetar, anëtarëve të atij fondi pensional vullnetar dhe personave të cilët do të mund të anëtarësohen në atë fond pensional vullnetar në të ardhmen, siguruesit dhe siguruesit potencialë, përveç deklaratave në formë dhe në mënyrë të përcaktuar nga Agjencia.

(3) Personat nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni janë:

a) shoqëritë;

b) personat ndërlidhur të shoqërive, dhe

c) agjentët ose të punësuarit në shoqëritë dhe në personat e ndërlidhur.

(4) Për shkak të sigurimit të informimit të drejtë dhe objektiv të publikut, Agjencia i miraton të gjitha materialet për marketing para shpalljes ose transmetimit të tyre. Agjencia miraton udhëzime për përmbajtjen e reklamave dhe materialit tjetër të shkruar promovues të fondeve pensionale vullnetare dhe të shoqërive. Shoqëria është e detyruar t'i paraqesë materialet në miratim Agjencisë dhe nuk guxon të shpallë ose emitojë material të pamiratur për marketing.

(5) Nëse Agjencia llogarit se ndonjë reklamë ose material tjetër i shkruar mund të shkaktojë lajthitje, me aktvendim mund ta ndalojë ose anulojë shpalljen ose shpërndarjen dhe të urdhërojë shpallje të ndryshimit të atij materiali në afat të cilin vetë e përcakton.

Neni 108

(1) Është e ndaluar kryerja e marketingut në fondin pensional vullnetar e personit në lokalet e tij të punës.

(2) Personi përgjegjës nuk guxon që të punësuarit t'i reklamojë fond pensional vullnetar, përveç në rast kur punëdhënësi ka organizuar skemën e vet profesional për të punësuarit e vet.

Neni 109

(1) Shoqëria mund të lidhë marrëveshje për anëtarësim me person vetëm përmes agjentit të regjistruar.

(2) Agjenti detyrimisht merr pjesë gjatë lidhjes së marrëveshjes për anëtarësim në fondin pensional vullnetar dhe është i detyruar ta nënshkruajë marrëveshjen e tillë.

(3) Punë marketingu në fondet pensionale mund të kryejë personi pas regjistrimit të tij në regjistrin e agjentëve.

(4) Agjenti mund të kryejë punë marketingu në të njëjtën kohë vetëm në një shoqëri për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme ose vetëm të një shoqërie për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare ose vetëm të një shoqërie për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.

(5) Agjenti është i detyruar që përsëri të regjistrohet të kryejë në të ardhmen marketing të shoqërisë tjetër nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Çdo person i cili kryen punë marketingu të fondit pensional vullnetar përmes telefonit dhe përmes qendrës telefonuese ka detyrim të jetë agjent i regjistruar.

(7) Agjencia mund ta shlyejë nga regjistri i agjentëve çdo person i cili nuk i respekton dispozitat nga ky ligj ose Ligji për sigurim pensional të detyrueshëm kapital financiar dhe nuk do t'i lejojë personit reregjistrim në regjistër, në afat prej tre vjetësh nga dita e shlyerjes.

(8) Agjencia organizon provim për marrjen e cilësisë së agjentit të cilin e japin të gjithë personat të cilët doemos duhet të bëhen agjentë të ndonjëres prej shoqërive nga paragrafi (4) i këtij neni.

(9) Personave të cilët doemos duhet të regjistrohen si agjentë në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat për kushtet për regjistrim në regjistrin e agjentëve, mënyrën dhe procedurën për dhënien e provimit dhe lëshimit të certifikatës për fitimin e cilësisë agjent nga neni 77 paragrafi (6), (7), (9), (10) dhe (11) i Ligjit për sigurim pensional të detyrueshëm kapital financiar.

Neni 110

Agjenti është i detyruar të gjitha që kontaktet me anëtarin ose me personat të cilët kanë të drejtë të bëhen anëtarë të fondit pensional t'i kryejë personalisht dhe nuk guxon të lidhë marrëveshje për anëtarësim nëpërmjet personit tjetër.

Neni 111

(1) Në rast se shoqëria nëpërmjet kontaktit personal të realizuar nga ana e të punësuarit të vet, përfaqësuesit ose agjentit të asaj shoqërie ose personit të ndërlidhur me atë shoqëri, t'i bëjë ndikim ndonjë anëtarit që ta ndërpresë anëtarësimin në fondin pensional vullnetar me të cilin udhëheq shoqëria tjetër dhe të bëhet anëtar i fondit pensional vullnetar të cilin udhëheq shoqëria e parë, ajo duhet doemos t'u japë prioritet interesave të atij anëtarit karshi interesave të veta ose të shoqërisë.

(2) Me kontakt personal në kuptimin e paragrafit (1) të këtij neni nënkuptohet takimi personal, biseda telefonike ose korrespondenca personale e adresuar ndërmjet personit të punësuar, përfaqësuesit ose agjentit të shoqërisë dhe personit për të cilin është fjala ose personit tjetër të ndërlidhur me të.

Neni 112

Ndalohet zbatimi i procedurave të marketingut të fondeve pensionale vullnetare që janë në kundërshtim me moralin publik dhe që mund të dëmtojnë sigurimin pensional vullnetar kapital financiar.

KREU 10

DETYRIMET PËR NJOFTIM DHE INFORMIM

Neni 113

(1) Çdo shoqëri është e detyruar që më së voni deri në 31 mars çdo viti në vijim, të shpallë prospekt informativ për fondin pensional vullnetar me të cilin udhëheq me të dhëna të vërteta dhe të sakta me gjendjen e 31 dhjetorit të vitit paraprak.

(2) Prospekti informativ për fondin pensional vullnetar i përmban të dhënat vijuese në lidhje me fondin pensional vullnetar dhe shoqërinë me të cilën udhëheq fondi pensional vullnetar:

- a) emrat e anëtarëve të këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës të shoqërisë;
- b) emrat dhe adresat e aksionarëve dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqërinë kapitale;
- c) emrin dhe selinë e ruajtësit të pronës dhe të dhëna për ndryshimet eventuale të ruajtësit të pronës të bërë vitin paraprak dhe arsytet për ndryshimet e atilla;
- ç) dokument për strategji investuese për periudhën nga paragrafi (1) i këtij neni, të cilat veçanërisht përmbajnë informacione për vetë kufizimet gjatë investimit përveç kufizimeve të përcaktuara në këtë ligj;
- d) kompensimet që paguhen nga anëtarët e fondit pensional vullnetar;
- dh) të dhënat e numëruara në nenin 114 paragrafi (3) i këtij ligji;
- e) numrin e anëtarëve të fondit pensional vullnetar;

ë) neto vlerën e mjeteve të fondit pensional vullnetar në datën e fundit të vlerësimit, përfundimisht me 31 dhjetor; dhe

f) të dhëna tjera për punën e shoqërisë që mund t'i përcaktojë Agjencia për shkak të sigurimit të transparencës.

(3) Të dhënat botohen në formë të broshurës së paku në njëërën nga gazetat ditore në tirazh që distribuohet në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(4) Formën e prospektit informativ e përcakton Agjencia.

(5) Shoqëria është e detyruar t'i mundësojë këqyrje në prospektin informativ dhe statutin e fondit pensional vullnetar me të cilin udhëheq, çdo personi i cili do të paraqitet për anëtarësim në fondin pensional vullnetar me të cilin udhëheq ajo shoqëri, para nënshkrimit të marrëveshjes për anëtarësim në fondin vullnetar pensional me të cilin udhëheq ajo shoqëri, para nënshkrimit të marrëveshjes për anëtarësim në fondin pensional vullnetar dhe të siguruesit.

(6) Shoqëria është e detyruar që me kërkesë nga anëtari i fondit vullnetar pensional, të mundësojë këqyrje në prospektin informativ, statutin dhe raportet financiare të fondit pensional vullnetar me të cilin udhëheq.

Neni 114

(1) Shoqëria është e detyruar që rregullisht, e së paku një herë në vit në formë të shkruar t'i informojë anëtarët e fondit vullnetar pensional për gjendjen e mjeteve të llogarive të tyre vullnetare individuale ose llogarive profesionale, për datat e pagimit të kontributeve dhe të bartjes së mjeteve për anëtarin e atij fondi gjatë periudhës përkatëse dhe për shndërrimin e kontributeve dhe mjeteve të bartura në njësi kontabiliteti.

(2) Me kërkesë nga anëtari i fondit vullnetar pensional, në çdo kohë, shoqëria është e detyruar që në afat prej tetë ditësh pune nga pranimi i kërkesës së tillë, anëtarit t'i dërgojë njoftim për vlefshmërinë e mjeteve në llogarinë e tij vullnetare individuale ose llogarinë profesionale.

(3) Së paku një herë në vit, shoqëria është e detyruar t'i dërgojë të dhëna secilit anëtar të fondit pensional vullnetar me të cilin ajo udhëheq për vlefshmërinë dhe pjesëmarrjen e mjeteve të fondit pensional të mjeteve të investuara në lloj të caktuar të mjeteve, duke përfshirë edhe të dhëna për botuesin e letrës përkatëse me vlerë, në datën fundit të vlerësimit përfundimisht me 31 dhjetor çdo vit. Detyrimi për dhënien e të dhënave për botuesit e letrave me vlerë ka të bëjë me investimet në letrat me vlerë të cilat paraqesin së paku 1% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar. Gjithashtu, shoqëria është e detyruar të paraqesë të dhëna për shumën e përgjithshme të provizioneve transaksionale të cilat i kanë paguar shoqërisë dhe menaxherët e saj të huaj të mjeteve të fondit pensional vullnetar të personave juridikë të cilët kanë siguruar shërbime të letrave me vlerë, në periudhën nga raporti i fundit dhe shumën mesatare të atyre shpenzimeve pas një njësie kontabiliteti të atij fondi pensional.

(4) Të dhënat nga paragrafi (1) dhe (3) të këtij neni u dërgohen anëtarëve të fondit pensional vullnetar pa pagesë. Shoqëria mund të paguajë kompensim për njoftimin nga paragrafi (2) të këtij neni, por vetëm deri te lartësia e shpenzimeve për botimin dhe shpenzimet postare.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (1) dhe (3) i këtij neni shoqëria nuk është e detyruar t'i dërgojë njoftim personit nëse ai nuk ka llogari vullnetare individuale ose llogari profesionale.

(6) Të dhënat nga paragrafi (1) dhe (3) i këtij neni dërgohen sipas nevojës edhe në periudha më të shkurta kohore të përcaktuara nga Agjencia. Agjencia për së afërmi e përcakton llojin dhe periudhën me të cilën kanë të bëjnë të dhënat, mënyrën dhe formën e tregimit të njëjtave dhe procedura për dërgimin e tyre.

Neni 115

Shoqëria e cila udhëheq me skemën përkatëse pensionale profesionale të siguruesit i dërgon informatat e theksuara në nenin 114 paragrafi (1) dhe (3) të këtij ligji për gjithë pjesëmarrësit në skemën pensionale profesionale dhe është i detyruar t'i respektojë kërkesat nga neni 114 paragrafi (2), (4), (5) dhe (6) i këtij ligji.

Neni 116

- (1) Shoqëria është e detyruar që Agjencisë t'i dërgojë informacionet vijuese:
- a) raporte tremujorëshe (të pareviduara) dhe raporte të reviduara financiare për shoqërinë;
 - b) raporte tremujorëshe (të pareviduara) themelore financiare, raporte plotësuese, raporte vjetore financiare të reviduara dhe raporte plotësuese për fondin pensional vullnetar;
 - c) të dhëna më të hollësishme për arritjen dhe bartjen e mjeteve në fondin pensional vullnetar me numërimin e çdo mjeti veç e veç, datën dhe çmimin e transaksionit dhe personit juridik i cili kryen shërbime me letra në vlerë;
 - ç) të dhënat më të hollësishme për shpenzimet, siç janë provizionet e transaksionit, kompensimet për ruajtësin e pronës, provizionet për agjentët që kryejnë punë të marketingut dhe shpenzime tjera në pajtim me këtë ligj;
 - d) të dhëna të aksionarëve të shoqërisë duke përfshirë emra dhe adresa;
 - dh) emrat e anëtarëve të këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës të shoqërisë dhe lartësinë e kompensimeve për punën e tyre;
 - e) ekzemplar nga prospekti informativ në pajtim me nenin 113 të këtij ligji;
 - ë) të dhënat nga neni 114 paragrafi (1) dhe (3) të këtij ligji;
 - f) të dhëna në detaje për numrin e anëtarëve të fondit pensional, numrin e anëtarëve të cilët janë anëtarësuar në fondin pensional vullnetar gjatë vitit, numrin e atyre të cilët kanë kaluar në fonde tjera pensionale vullnetare, numrin e anëtarëve të vdekur dhe numrin e anëtarëve të cilët kanë realizuar kompensim pensional;
 - g) të dhëna në detaje për të gjithë siguruesit të cilat kanë skema pensionale profesionale të përfshirë në fondin në të cilin udhëheq ose kanë pasur në gjatë vitit paraprak; dhe
 - gj) të dhëna tjera me kërkesë të Agjencisë.
- (2) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale të detyrueshme vullnetare dhe i dërgon Agjencisë informacione përmbledhëse për shoqërinë, por është e obliguar të paraqesë të dhëna të posaçme për çdo fond pensional me të cilin udhëheq.
- (3) Të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni dërgohen një herë në vit, ndërsa sipas nevojës edhe në periudha më të shkurta kohore të përcaktuara nga Agjencia. Agjencia për së afërmi e përcakton llojin dhe periudhën me të cilën kanë të bëjnë të dhënat, mënyrën dhe formën e përshkrimit të njëjtave dhe procedurën për dërgimin e tyre.
- (4) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, të dhënat nga paragrafi (1) pika c) të këtij neni dërgohen një herë në vit, ndërsa sipas nevojës edhe në periudha më të shkurta kohore të përcaktuar nga Agjencia. Agjencia për së afërmi e përcakton llojin dhe periudhën me të cilën kanë të bëjnë të dhënat, mënyrën dhe formën e përshkrimit të të njëjtave dhe procedurën për dërgimin e tyre.

KREU 11 KOMPENSIMET

Neni 117

- (1) Shoqëria mund t'i paguajë veçanërisht kompensimet si vijon:
- a) kompensim nga kontributi si përqindje nga çdo kontribut i paguar në fondin pensional vullnetar, para transformimit të tyre në njësi kontabiliteti. Kompensimin nga kontributi e përcakton shoqëria, por ai mundet t'i tejkalojë 7 përqin nga çdo kontribut i paguar;
 - b) kompensim mujor si përqindje nga vlefshmëria e neto mjeteve të fondit pensional vullnetar, për mbulimin e shpenzimeve të shoqërisë. Kompensimin mujor e përcakton shoqëria, por ai nuk mund t'i tejkalojë 0,15 përqin në muaj. Përlllogaritja e kompensimit kryhet në çdo datë të llogaritjes së mjeteve të fondit pensional vullnetar dhe paguhet një herë në muaj;
 - c) kompensimin në rast të bartjes së mjeteve në llogarinë individuale të anëtarit nga një fond pensional vullnetar në tjetër fond pensional vullnetar, me kusht që anëtari i cili kalon të jetë anëtar në fondin pensional vullnetar të përhershëm më shkurtër se një vit para se të kalojë në

fondin vullnetar të ardhshëm. Shumën maksimale të kompensimit në para dhe mënyrën e pagimit për së afërmi e përcakton Agjencia në pajtim paraprak nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(2) Kompensimin nga paragrafi (1) pika c) i këtij neni e paguan anëtari i fondit pensional i cili i bashkohet fondit pensional të ardhshëm. Shoqëria e cila udhëheq me fondin pensional në të cilin bashkohet anëtari ose përfaqësuesi i shoqërisë nuk guxon ta paguajë këtë kompensim.

(3) Kompensimi nga paragrafi (1) pika c) i këtij neni nuk paguhet në këto raste:

a) nëse shoqëria e cila doemos duhet të kryejë bartje të mjeteve nga një fond pensional në tjetër fond pensional i ka rritur ose njoftuar për rritjen e kompensimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, në periudhë prej 180 ditësh para datës së bartjes së atillë të mjeteve;

b) nëse anëtari nuk ka mjete në llogarinë profesionale ose në llogarinë vullnetare individuale;

c) nëse mjetet barten nga një llogari profesionale në tjetër ose nga llogaria profesionale në llogarinë vullnetare individuale për shkak të ndryshimit të siguruesit;

ç) nëse Agjencia tregon se personi është anëtarësuar në atë fond pensional vullnetar si pasojë e marketingut dhe aktiviteteve reklamuese në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

d) nëse mbi shoqërinë e cila udhëheq me atë fond pensional është e hapur procedurë e falimentimit ose leja për udhëheqje me atë fond pensional vullnetar i është tërhequr ose anuluar, ose

dh) në rast të bashkimit ose bashkëngjitjes së shoqërisë e cila doemos duhet të kryejë bartje të mjeteve nga një fond pensional vullnetar në tjetër, në periudhën prej 180 ditësh pas bashkimit ose bashkëngjitjes.

Neni 118

(1) Kompensimet nga neni 117 paragrafi (1) nga ky ligj shoqëria i paguan në shkallë të njëjtë nga të gjithë anëtarët e fondit pensional vullnetar, përveç në rast të anëtarëve që janë pjesëmarrës në skemën profesionale të pensionit.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, kompensimet nga neni 117 paragrafi (1) pikat a) dhe b) të këtij ligji mund të zvogëlohen për të gjithë anëtarët e fondit pensional vullnetar që kanë qenë anëtarë të atij fondi pensional për periudhën kohore të përcaktuar nga ana e shoqërisë. Zvogëlimi i kompensimit bëhet në mënyrë të njëjtë që të mos bëhet dallim midis anëtarëve që kanë qenë anëtarë në të njëjtin fond pensional vullnetar në të njëjtën periudhë kohore.

Neni 119

(1) Shoqëria është e detyruar që t'i informojë të gjithë anëtarët e fondit pensional për secilin propozim për zmadhimin e kompensimeve nga neni 117 paragrafi (1) nga ky ligj, së paku 180 ditë para implementimit dhe për secilin propozim për zvogëlimin e kompensimeve nga neni 117 paragrafi (1) nga ky ligj, së paku 30 ditë para implementimit të tij.

(2) Njoftimi nga paragrafi (1) i këtij neni bëhet në formë të shkruar dhe i dorëzohet secilit anëtarë të fondit pensional dhe Agjencisë. Njoftimi botohet së paku edhe në një gazetë ditore në Republikë.

(3) Kur një anëtar kalon nga një fond pensional vullnetar në fond tjetër, shoqëria e cila administron me fondin e ardhshëm pensional vullnetar i jep në shikim ekzemplarë të njoftimit nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 120

(1) Provizionet e transaksionit në lidhje me transaksionet për fitimin ose bartjen e mjeteve të fondit pensional paguhen nga mjetet e fondit pensional.

(2) Shoqëria është e detyruar që të bëjë kontrollin e provizioneve që paguhen nga mjetet e fondit pensional me të cilat ai administron, të personave juridikë të zgjedhur që bëjnë shërbime me letrat me vlerë të lidhur në mënyrë direkte me tregtinë e mjeteve të fondeve pensionale, për

shkak të sigurisë se ato provizione janë plotësisht konkurrencte me provizionet që i paguajnë personat tjerë juridikë për transaksione të ngjashme. Për shkak të mbrojtjes së interesave të anëtarëve të fondeve pensionale, Agjencia mund të ndalojë personin e lidhur të shoqërisë që të bëjë shërbime me letrat me vlerë në të lidhur mënyrë direkte me tregtinë me mjetet e fondeve pensionale.

(3) Për shkak të sigurimit të konkurrencës nga paragrafi (2) nga ky nen, zgjedhja e personave juridikë nga vendi që mund të bëjnë shërbime me letrat me vlerë bëhet në bazë të: provizionit më të ulët, vëllimit të tregtisë, aftësisë së kuadrit, aftësisë teknike dhe organizative. Që të zgjidhet personi juridik nga vendi duhet të ketë të punësuar së paku dy brokerë të autorizuar, me së paku 2 vjet përvojë pune si broker i autorizuar.

(4) Agjencia i përcakton vëllimin e duhur të tregtisë, aftësimin e kuadrit, aftësinë teknike dhe organizative.

(5) Zgjedhja e personave juridikë që bëjnë shërbime me letrat me vlerë bëhet për periudhë prej një viti, sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.

(6) Agjencia u jep pëlqim marrëveshjeve të lidhura midis shoqërisë dhe personave juridikë që bëjnë shërbime me letrat me vlerë. Me marrëveshjen shoqëria Agjencisë ia dorëzon edhe listën tarifore për provizione.

Neni 121

Të gjitha shpenzimet tjera në lidhje me menaxhimin me fondin pensional vullnetar që nuk janë mbuluar me provizione, kompensime ose detyrime të përcaktuara në këtë ligj, janë në barrë të shoqërisë që menaxhon me atë fond pensional vullnetar.

KREU 12

PUNA ME LLOGARITË DHE VLERËSIMI I MJETEVE TË FONDIT PENSIONAL VULLNETAR

Neni 122

(1) Kontributet, mjetet e bartura dhe të gjitha fitimet nga investimet e tyre sistemohen në llogari individuale që janë në emër të anëtarëve të fondeve pensionale vullnetare.

(2) Evidencën e llogarive individuale të fondit pensional vullnetar e mban shoqëria e cila menaxhon me atë fond.

Neni 123

(1) Për evidentimin e llogarive individuale dhe mjetet e fondeve pensionale vullnetare shfrytëzohen evidencat e kontabilitetit.

(2) Gjatë kryerjes së vlerësimeve, një njësi e kontabilitetit paraqet pjesë proporcionale në neto mjetet e përgjithshme të atij fondi pensional.

(3) Vlera e numrit të përgjithshëm të njësisë të kontabilitetit të fondit pensional vullnetar është gjithmonë e barabartë me vlerën e përgjithshme të mjeteve të atij fondi, të llogaritur në pajtim me nenin 124 të këtij ligji.

(4) Mjetet nga paragrafi (1) të këtij neni mund të shndërrohen edhe në pjesë të njësisë së kontabilitetit, kurse vlera e mjeteve të llogarisë individuale të anëtarit të fondit pensional vullnetar, gjithashtu, mund të shprehet në një pjesë të njësisë së kontabilitetit.

Neni 124

(1) Vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar përcaktohet në bazë të vlerës së tregut për çdo mjet të veçantë.

(2) Vlera e neto mjeteve të fondit pensional vullnetar përcaktohet me zvogëlimin e obligimeve të fondit pensional, përveç obligimeve ndaj anëtarëve të fondit pensional, nga vlera e mjeteve të fondit pensional.

(3) Mënyrën e vlerësimit të mjeteve të fondeve pensionale vullnetare dhe llogaritjen e neto vlerës së mjeteve të tyre më për së afërmi e përcakton Agjencia, me mendimin paraprak nga Komisioni i letrave me vlerë i Republikës së Maqedonisë.

Neni 125

(1) Shndërrimi i mjeteve të kontributeve në njësi të kontabilitetit bëhet në data të caktuara paraprakisht (datat e vlerësimit), në bazë të vlerës së njësive të kontabilitetit të asaj date. Data e vlerësimit çdo herë është në ditën e fundit të punës të çdo muaji. Agjencia përcakton afate më të shkurta të datës së vlerësimit, nëse sigurimi pensional me financim kapital dhe tregu financiar ka nevojë.

(2) Vlerën e një njësie të kontabilitetit në datën e parë të vlerësimit pas arkëtimit të parë të kontributeve në fondin pensional vullnetar më së afërmi e përcakton Agjencia.

(3) Deri në shndërrimin e kontributeve në njësi kontabiliteti, të njëjtat ruhen në llogari të veçantë të fondit pensional vullnetar. Kamata e atyre mjeteve paraqet të ardhura të fondit pensional vullnetar.

Neni 126

(1) Vlera e neto mjeteve të fondit pensional vullnetar llogaritet në çdo datë të vlerësimit, për çka menjëherë njoftohet Agjencia.

(2) Në secilën datë të vlerësimit llogaritet edhe vlera e njësisë së kontabilitetit të atij fondi pensional, për çka shoqëria menjëherë e njofton Agjencinë.

(3) Llogaritë nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni i bën shoqëria dhe ato janë lëndë e kontrollit të Agjencisë.

(4) Shoqëria është e detyruar që ta ndryshojë vlerën e bërë për ndonjë letër me vlerë me kërkesë të Agjencisë nëse ajo gjatë kontrollit konstaton se shoqëria gjatë vlerësimit ka shfrytëzuar çmim llogaritës jo adekuat për letrën me vlerë ose vlera objektive nuk i përgjigjet gjendjes reale të tregut, si dhe kur janë të rrezikuar interesat e anëtarëve.

Neni 127

(1) Në fund të muajit qershor çdo vit shoqëria e cila menaxhon me ndonjë fond pensional vullnetar është e detyruar ta përcaktojë fitimin për 36 muajt paraprak, në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni. Në rast se një fond pensional vullnetar nuk ka pranuar kontribute për periudhë prej 36 muaj, ndërsa ka pranuar kontribute për periudhë prej 12 muajve, në fund të qershorit dhe dhjetorit do të përcaktohet fitimi për 12 muaj, ose nëse ka pranuar kontribute për 24 muaj, për atë periudhë kohore. Të dhënat për fitimin dorëzohen në Agjencinë e cila mund t'i publikojë.

(2) Fitimi i fondit pensional vullnetar paraqet dallimin midis vlerës së njësisë së kontabilitetit në datën e fundit të vlerësimit gjatë muajve të përcaktuar në paragrafin (1) nga ky nen dhe vlera e njësisë në ditën e fundit të punës të muajit në fund të periudhës mujore 12, 24 ose 36, në raport me vlerën e njësisë në ditën e fundit të punës të muajit në fund të periudhës mujore 12, 24 ose 36, varësisht nga rasti konkret. Fitimi shprehet në përqindje.

Neni 128

Agjencia së afërmi i rregullon:

a) Metodologjinë e llogaritjes së fitimit të fondeve pensionale vullnetare dhe metodat për kompletimin e atyre vlerave.

b) Datën në të cilën shoqëria është e detyruar ta informojë Agjencinë për vlerën e neto mjeteve të fondit pensional vullnetar, metodologjinë precize për përcaktimin e datave në fund të qershorit dhe dhjetorit me të cilën gjendje do të bëhen llogaritë, metodologjia e vlerësimit, vlera e njësisë së kontabilitetit, fitimi i fondit pensional vullnetar, dhe për mënyrën e njoftimit të tillë.

Neni 129

(1) Kontabiliteti i shoqërive dhe i fondeve pensionale vullnetare bëhet në pajtim me ligjet dhe me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

(2) Agjencia së afërmi e përcakton planin e kontabilitetit, formën dhe përmbajtjen e raporteve themelore financiare, raportet plotësuese për fondet pensionale vullnetare, si dhe përmbajtjen e llogarive të veçanta në planin e kontabilitetit për fondet pensionale.

(3) Agjencia së afërmi e përcakton formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare të shoqërive.

KREU 13

INVESTIMI I MJETEVE TË FONDIT PENSIONAL VULLNETAR

Neni 130

(1) Mjetet e fondeve pensionale vullnetare investohen në pajtim me dispozitat e këtij ligji, në pajtim me strategjinë investuese dhe me qëllim të realizimit të fitimit më të madh kryesisht në dobi të anëtarëve të fondit pensional vullnetar, në bazë të principeve si vijon:

- a) sigurisë së mjeteve të fondit pensional vullnetar;
- b) diversifikimit të rrezikut nga investimet, dhe
- c) mbajtjes së likuiditetit adekuat.

(2) Investimi i bërë për shkak të disa qëllimeve tjera paraqet cenim i obligimeve të shoqërisë.

Neni 131

(1) Në bazë të dispozitave nga neni 132 dhe 133 nga ky ligj, mjetet e fondit pensional vullnetar mund të investohen vetëm në llojet e instrumenteve si vijon:

a) depozita bankare në banka që kanë leje të marrë nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, nëse tërheqin kamata;

b) obligacione dhe letra tjera me vlerë që i ka dhënë ose për të cilat garanton Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë;

c) certifikata për depozitim, shkresa komerciale dhe obligacione të emetuara ose të garantuara nga bankat që kanë leje të lëshuara nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë;

ç) letra me vlerë në bazë të hipotekës të lëshuar nga bankat që kanë leje të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë;

b) obligacione dhe letra tjera me vlerë që i jep ose për të cilat garanton Republika e Maqedonisë;

dh) aksione të dhëna në bazë të lejes nga Komisioni për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë nga shoqëri aksionare të vendit që nuk janë fonde investuese, që kanë kuotë në tregun oficial në bursën e letrave vlerë afatgjate ose në treg tjetër të organizuar të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë të cilin e kontrollon Komisioni;

e) obligacione të dhëna në bazë të lejes nga Komisioni i letrave me vlerë të Republikës së Maqedonisë, nga shoqëri aksionare të vendit që nuk janë banka, që kanë kuotë në tregun oficial në bursën e letrave afatgjate me vlerë ose në treg tjetër të organizuar të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë që e kontrollon Komisioni;

ë) shkresa komerciale të dhëna nga shoqëri aksionare në Republikën e Maqedonisë që nuk janë banka;

f) dokumente për pjesëmarrje dhe aksione të fondeve investuese në Republikën e Maqedonisë që kanë leje nga Komisioni për letrat me vlerë të Republikës së Maqedonisë;

g) obligacione dhe letra tjera me vlerë të lëshuara nga ana e qeverisë dhe bankat qendrore të vendeve anëtare të Unionit Evropian dhe vendeve anëtare të OECD;

gj) letra me vlerë debitori të lëshuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane Investuese dhe Banka Botërore;

h) letra me vlerë debitori që kanë rejting të preferuar për investim sipas rejtingut të agjencive ndërkombëtare kreditore, të lëshuara nga njësitë e vetadministrimit lokal, jo shtetërore, kompani të huaja ose banka nga vendet anëtare të UE dhe vendet anëtare OECD;

i) aksione të dhëna nga kompani të huaja ose banka që kanë rejting preferues për investim sipas rejtingut të agjencive ndërkombëtare kreditore, me të cilat tregtohet në bursat kryesore në vendet anëtare të UE dhe vendet anëtare OECD;

j) dokumente për pjesëmarrje, aksione dhe letra tjera me vlerë të lëshuara nga fondet autorizuese investuese të hapura dhe të mbyllura me seli në vendin anëtar të UE dhe vendet anëtare të OECD; dhe

k) lloj tjetër të depozitimit në pajtim me aktet e Agjencisë, me kusht që ajo të mos jetë në kundërshtim me nenin 134 të këtij ligji, me mendim paraprak të Komisionit për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë.

(2) Tregtia me letra me vlerë të fondeve pensionale bëhet në tregje të rregulluara sekondare, në tregje nëpërmjet sporteleve dhe tregje primare për instrumentet që i plotësojnë kushtet e këtij neni.

(3) Mjetet e fondeve pensionale vullnetare mund të shfrytëzohen për investim në instrumente që i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Agjencia për:

a) kushtet që duhet t'i plotësojnë tregjet e rregulluara sekondare të kapitalit ku bëhet tregtia me mjetet e këtyre fondeve pensionale;

b) kualitetin e aksioneve, obligacioneve dhe instrumenteve tjera në të cilat janë depozituar mjetet e fondeve pensionale, dhe

c) vendet ose grupet e vendeve në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve pensionale.

Neni 132

(1) Agjencia i përcakton shumat më të larta të depozitimit në një kompani, respektivisht shoqëri tregtare ose në një instrument, në të cilin mund të investohen mjetet e një fondi pensional, me mendim paraprak të Komisionit për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë .

(2) Agjencia e përcakton shumën më të lartë të ndonjë lloji të instrumentit në të cilin mund të depozitohen mjetet e fondit pensional, me mendim paraprak të Komisionit për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë.

(3) Agjencia e përcakton shumën më të lartë të depozitimeve në instrumente të grupit të njëjtë ekonomik të regjistruar në Republikën e Maqedonisë, në vendet anëtare të Unionit Evropian ose në vendet anëtare të OECD, me mendim paraprak të Komisionit të letrave me vlerë të Republikës së Maqedonisë.

(4) Agjencia nuk mund të përcaktojë shuma më të ulëta në të cilat detyrimisht duhet të depozitohen në fondin pensional vullnetar.

(5) Agjencia mund të bëjë zvogëlimin e shumave nga paragrafi (3) të këtij neni edhe të shumave nga neni 133 nga ky ligj, me njoftim paraprak të dërguar në të gjitha shoqëritë për menaxhim me fondet pensionale së paku 180 ditë para zvogëlimit të tillë.

Neni 133

Depozitimet në lloje të veçanta të instrumenteve në pajtim me nenin 131 paragrafi (1) nga ky ligj u nënshtrohen përkufizimeve si vijon:

a) së paku 50% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar mund të depozitohen në instrumente të emetuesve të huaj të instrumenteve financiare jashtë Republikës së Maqedonisë. Në suazat e këtij përkufizimi së paku 30% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar mund të depozitohen në instrumentet e theksuara në nenin 131 paragrafi (1) pikat j), k) dhe l) të këtij ligji;

b) më së shumti 80% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar mund të depozitohen në instrumentet e theksuara në nenin 131 paragrafi (1) pikat b) dhe d) të këtij ligji;

c) më së shumti 60% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar mund të depozitohen në instrumentet e nenit 131 paragrafi (1) pikat a), v) dhe g) të këtij ligji;

ç) më së shumti 40% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar mund të depozitohen në instrumentet e theksuara në nenin 131 paragrafi (1) pikat e) dhe zh) të këtij ligji;

d) më së shumti 30% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar mund të depozitohen në instrumentet e theksuara në nenin 131 paragrafi (1) pika gj) të këtij ligji, dhe

dh) më së shumti 5% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar mund të depozitohen në instrumentet e theksuara në nenin 131 paragrafi (1) pika z) të këtij ligji.

Neni 134

Mjetet e fondit pensional vullnetar nuk mund të investohen në llojet e instrumenteve si vijon:

a) aksione, obligacione dhe letra tjera me vlerë që nuk janë në kuotën e tregut oficial ose me të cilat publikisht nuk tregtohet;

b) instrumente me të cilat nuk mund në mënyrë juridike të zotërohet;

c) të mira materiale të cilat rrallë herë janë në kuotën e tregjeve të organizuara dhe vlera e të cilave është e pasigurt, si për shembull antikitetet, vepra artistike dhe mjete motorike;

ç) pronë të patundshme dhe çfarëdo pjesëmarrje në pronë të patundshme përveç letrave me vlerë të lëshuara në bazë të hipotekës dhe depozitimit direkt nëpërmjet fondeve investuese të hapura dhe të mbyllura;

d) aksione, obligacione dhe letra tjera me vlerë të lëshuara nga:

1) aksionari i shoqërisë;

2) rojtari i pronës të fondit pensional vullnetar, dhe

3) personat e lidhur me subjektet e theksuara në nënpikat 1) dhe 2) të kësaj pike;

dh) fjuçers-marrëveshje, marrëveshje opsionesh, forward-marrëveshje dhe instrumente tjera derivative, dhe

e) instrumente tjera të përcaktuara nga Agjencia me mendim paraprak të Komisionit për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë, në të cilat depozitimi do të jetë në kundërshtim me interesat e anëtarëve të fondit pensional.

Neni 135

(1) Në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji si rezultat i ndryshimit të çmimeve të tregut, ndryshimit të kurseve devizore të valutave të huaja, ndryshimit të marrëdhënieve organizative ose ekonomike midis subjekteve në të cilat janë depozituar mjetet e fondit pensional vullnetar, rrethanave tjera jashtë kontrollit direkt të shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale vullnetare, atëherë shoqëria e cila menaxhon me fondin është e detyruar që menjëherë ta njoftojë Agjencinë, që të pushojë me depozitimet në atë instrument dhe të ndërmarrë masa për harmonizimin e aktiviteteve investuese në fondin pensional vullnetar, me dispozitat e këtij ligji.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) të këtij neni, shoqëria e cila menaxhon me fondin pensional nuk është e detyruar që menjëherë të ndërmarrë masa për korrigjimin e tejkalimeve të përkufizimeve investuese të përcaktuara në këtë ligj, nëse tejkalimi për njësi nuk është më i madhe se 20% nga kufizimi dhe shuma e të gjitha tejkalimeve nuk kalon 5% nga neto vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar.

(3) Shoqëria e cila menaxhon me fondin pensional është e detyruar që të bëjë harmonizimin e aktivitetit investues të fondit pensional investues me të cilin menaxhon me kushtet e këtij ligji në afat prej 180 ditësh duke konsideruar nga data e shkeljes së kryer ose nga data e vlerësimit të mjeteve të fondit pensional kur është bërë e njohur së është bërë shkelja e këtij ligji, varësisht nga ajo cili veprim fillimisht është bërë.

(4) Me kërkesë të shoqërisë e cila menaxhon me fondin pensional, të dorëzuar në afat prej 30 ditësh pas datës së shkeljes së bërë të këtij ligji, Agjencia ka të drejtë ta vazhdojë afatin nga paragrafi (3) të këtij neni për së paku 180 ditë, nëse ai vazhdim është i domosdoshëm për shkak të mbrojtjes së interesave të anëtarëve të fondit pensional.

Neni 136

Shoqëria nuk guxon:

a) t'ia shesë mjetet e fondit pensional vullnetar vetvetes, fondit pensional të detyrueshëm me të cilat menaxhon, ruajtësit të pronës i cili i ruan mjetet e tija, menaxherëve të huaj të mjeteve, siguruesve që kanë skema profesionale të pensioneve të inkuadruara në atë fond pensional vullnetar dhe personit të lidhur me ndonjë prej këtyre personave, përveç nëpërmjet transaksionit të kryer nëpërmjet bursës së letrave me vlerë të autorizuar nga ana e Komisionit për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë respektivisht organi kompetent adekuat në rast të investimit të mjeteve jashtë vendit kur nuk e din ose nuk supozon se kush është blerësi;

b) të blejë, me mjetet e fondit pensional vullnetar, mjetet e personave të theksuar në pikën a) të këtij paragrafi, përveç nëpërmjet transaksionit të bërë nëpërmjet bursës së letrave me vlerë të autorizuar nga ana e Komisionit për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë respektivisht organit adekuat kompetent në rast të investimit të mjeteve jashtë vendit kur nuk e di ose nuk supozon se kush është shitësi; dhe

c) t'i shfrytëzojë mjetet e fondit pensional vullnetar për lejimin e huave dhe garancive.

Neni 137

(1) Shoqëria, aksionarët e shoqërisë, ruajtësi i pronës, menaxhuesit e mjeteve, anëtarët e këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës dhe cilido qoftë person, duke i përfshirë të punësuarit në Agjenci, të cilët si rezultat i pozitës zyrtare kanë marrë informatë për investimin e mjeteve të fondit pensional vullnetar ose për investimin e planifikuar, kurse informata e tillë nuk ka qenë zyrtarisht e botuar në tregun dhe ka mundur të ndikojë në çmimet e instrumenteve të kuotuar, janë të detyruar që informatën ta ruajnë si tepër sekret sipas klasifikimit me shkallë adekuate të fshehtësisë në pajtim me ligjin.

(2) Personat nga paragrafi (1) nga ky nen nuk guxojnë direkt ose indirekt që ta shfrytëzojnë informatën e besuar nga paragrafi (1) të këtij neni, me qëllim të fitimit të interesit për vete ose për të tjerë nëpërmjet shitjes dhe blerjes së letrave me vlerë, përveç për fondin pensional vullnetar.

(3) Shoqëria është e detyruar që ta kompensojë dëmin që direkt i është shkaktuar fondit pensional vullnetar nga ana e shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale vullnetare, drejtorit, personave përgjegjës dhe të punësuarve tjerë ose personave të angazhuar, si rezultat i shkeljes së dispozitave nga ky ligj, e veçmas dispozitat e këtij neni dhe nenit 130, 131, 132, 133, 134, 135, 136, 138, 139, 140, 141 dhe 142 nga ky ligj.

(4) Agjencia e përcakton mënyrën e pengimit të keqpërdorimit të informatave nga paragrafi (1) të këtij neni të marrë si rezultat i pozitës zyrtare.

Neni 138

(1) Shoqëria është e detyruar të menaxhojë me mjetet e fondit pensional vullnetar dhe nuk guxon t'ua bartë menaxhimin të tjerëve.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëria e cila menaxhon me fondin pensional vullnetar mund menaxhimin me mjetet e fondit pensional jashtë vendit t'ia besojë menaxherit ose menaxherëve të mjeteve me seli në vend të huaj, nëse të njëjtit kanë autorizim për menaxhim me mjetet në pajtim me ligjet e shtetit amë.

(3) Në rastet nga paragrafët (2) të këtij neni, me statutin e shoqërisë që menaxhon me fondin pensional përcaktohen kriteret dhe mënyrat për bartjen e menaxhimit me mjetet e fondit pensional vullnetar në vendin e huaj.

(4) Shoqëria është e detyruar ta njoftojë Agjencinë për ndryshimet e menaxherit të mjeteve, por nuk është e detyruar të kërkojë leje për atë.

(5) Agjencia së afërmi e rregullon bartjen e menaxhimit me mjetet e fondit pensional vullnetar menaxherit të jashtëm të mjeteve.

Neni 139

(1) Personat nga neni 137 paragrafi (1) nga ky ligj janë të detyruar ta njoftojnë Agjencinë për secilin transaksion me letra me vlerë të cilën e kanë lidhur në emër të vet dhe në llogari të vete, çdo 180 ditë ose më pak me kërkesë të Agjencisë.

(2) Agjencia e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e njoftimit nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 140

(1) Secila shoqëri e cila menaxhon me fondin pensional vullnetar duhet të ketë dokument për strategji investuese dhe të bëjë revidimin e sajë së paku çdo tre vjet.

(2) Dokumenti për strategji investuese së paku duhet të përmbajë metoda për matjen e rrezikut investues, proceseve për menaxhim me rrezik dhe sistemimin strategjik të mjeteve.

(3) Agjencia në detale e përcakton përmbajtjen e dokumentit për strategji investuese.

Neni 141

(1) Shoqëria e cila menaxhon me fondin pensional mund të obligohet në emër dhe në llogari të fondit pensional vullnetar me të cilin menaxhon ekskluzivisht për shkak të përmirësimit të likuiditetit të fondit pensional privat.

(2) Shuma e përgjithshme e mjeteve të huazuara nuk guxon të tejkalojë përqindjen e caktuar të mjeteve të fondit pensional vullnetar që së afërmi e përcakton Agjencia, por më së shumti deri në 5%.

Neni 142

Për shkak të mbrojtjes së interesave të anëtarëve të fondeve pensionale Agjencia mund të miratojë përkufizime plotësuese në lidhje me investimin, me pëlqim paraprak të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

KREU 14 KOMPENSIMI PENSIONAL

Neni 143

(1) Anëtari i fondit pensional vullnetar fiton të drejtën e kompensimit pensional nga sigurimit pensional me financim kapital vullnetar më herët, dhjetë vjet para moshës për fitimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë në pajtim me Ligjin për sigurim pensional invalidor.

(2) Anëtari është i detyruar që ta bëjë përzgjedhjen e vet nga neni 144 paragrafi (1) nga ky ligj më së voni deri 70 vjet moshë. Nëse anëtari nuk e bën përzgjedhjen, shoqëria e informon për obligimin për përzgjedhje.

(3) Para përzgjedhjes së mënyrës së pagesës së kompensimit pensional, me kërkesë të anëtarit, shoqëria është e detyruar ta informojë për shumën e llogarisë së tij vullnetare dhe llogarisë profesionale edhe për përzgjedhjen nga neni 144 të këtij ligji.

Neni 144

(1) Kur anëtari i fondit pensional vullnetar fiton të drejtën e kompensimit pensional, e tërë shuma e mjeteve të akumuluar në llogarinë e tij do të shfrytëzohet, me të drejtën e zgjedhjes personale të anëtarit, për:

- a) pagimin e shumës së përgjithshme të llogarisë së tij, të njëhershme ose në më shumë herë;
- b) blerjen e anuitetit pensional që paguhet deri në fund të jetës nga institucioni i veçantë i autorizuar për këtë qëllim;
- c) tërheqje të programuara, të siguruar nga shoqëria e cila menaxhon me fondin pensional vullnetar në të cilin ai ka qenë anëtarë në ditën e pensionimit, dhe
- ç) kombinimin e opsioneve të theksuara në pikat a), b) dhe c) të këtij paragrafi.

(2) Nëse shuma që gjendet në llogarinë e anëtarit është më e vogël se shuma e përcaktuar nga Agjencia, anëtari ka të drejtë vetëm në kompensim pensional nga paragrafi (1) pika a) e këtij neni.

Neni 145

Në rast të vdekjes së anëtarit të fondit pensional, mjetet nga llogaria e atij anëtari bëhen pjesë e masës së trashëgimisë së trashëgimlënësit dhe me ato mjete veprohet në pajtim me Ligjin e trashëgimisë.

Neni 146

Kur te anëtari i fondit pensional vullnetar konstatohet paaftësia e përgjithshme për punë nga ana e Komisionit për vlerësimin e aftësisë së punës pranë Fondit të sigurimit pensional invalidor të Maqedonisë, ai ka të drejtë, pa marrë parasysh moshën, të zgjedhë njërën prej mundësive për kompensim pensional të theksuar në nenin 144 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 147

Sigurimi i kompensimeve pensionale bëhet në pajtim me ligjin.

KREU 15 ROJTARI I PRONËS

Neni 148

(1) Shoqëria për menaxhim me Fondet pensionale vullnetare është e detyruar të zgjedhë rojtarin unik të pronës, të cilit ia beson përgjegjësinë për ruajtjen e mjeteve të fondit pensional vullnetar. Shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshëm dhe vullnetar mund të ketë të njëjtin rojtar të pronës edhe për fondin pensional vullnetar edhe për fondin pensional të detyrueshëm.

(2) Nëse fondi pensional vullnetar ka mjete jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë, rojtari i pronës zgjedh edhe sub-rojtarin e pronës për ruajtjen e atyre mjeteve, që është bankë ose institucion i specializuar depozitar, që ka leje për punë të dhënë nga organi kompetent në vendin jashtë Republikës së Maqedonisë dhe që është e autorizuar për veprimtari të tillë në pajtim me ligjet e shtetit ku do të bëjë ruajtjen e mjeteve të fondit pensional vullnetar. Sub-rojtari i zgjedhur i pronës detyrimisht duhet të ketë rejting të rekomanduar për investim sipas rejtingut të agjencive me renome ndërkombëtare për kredi. Agjencia së afërmi i përcakton kriteret për rejting të sub-rojtarit të pronës.

(3) Të gjithë instrumentet në të cilat janë depozituar mjetet e fondit pensional detyrimisht duhet të ruhen nga ana e rojtarit të pronës. Të gjitha hyrje dhe daljet e mjeteve financiare të fondit pensional bëhen kryesisht prej llogarive të fondit pensional vullnetar që janë të hapura dhe mbahen te rojtari i pronës.

(4) Rojtari i pronës mund të bëjë shërbimet e ruajtjes së mjeteve për më shumë fonde pensionale vullnetare dhe të detyrueshëm, por është i detyruar që ruajtjen e mjeteve, punën në lidhje me ato mjete dhe evidencën e secilit fond pensional ta bëjë veç e veç për secilin fond pensional ndaras nga komitentët tjerë dhe ndaras nga mjetet, puna dhe evidenca e vet.

Neni 149

(1) Rojtar i pronës së mjeteve të vendit është banka e cila ka leje të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.

(2) Për kryerjen e punëve të ruajtjes së mjeteve të fondeve pensionale vullnetare, rojtari i pronës detyrimisht duhet t'i plotësojë kushtet si vijon:

a) të ketë së paku mjete personale në shumë prej 9 000 000 euro me kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me definicionin për mjete personale në Ligjin për bankat dhe pëlqimin nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë për kryerjen e aktiviteteve të rojtarit të pronës;

b) të mos jetë aksionar në shoqërinë e cila menaxhon me fondin pensional vullnetar pasurinë e të cilit e ruan, as aksionar në menaxherin e huaj të mjeteve të atij fondi pensional vullnetar, as aksionar në ndonjë person të lidhur me shoqërinë dhe të mos ketë asnjë lidhje kapitale midis këtyre personave; dhe

c) anëtarët e këshillit drejtues ose këshillit mbikëqyrës të rojtarit të pronës dhe të punësuarve tjerë në rojtarin e pronës të mos jenë anëtarë të këshillit drejtues ose të këshillit mbikëqyrës, drejtor i përgjithshëm, drejtor ose të punësuar tjerë në shoqëri mjetet e të cilit i ruan, as në menaxherin e huaj të mjeteve dhe të mos jenë në raporte të njëjta me persona tjerë që janë persona të lidhur me shoqërinë ose menaxher i tij i mjeteve nga jashtë vendi .

3) Banka e cila bën punën e rojtarit të pasurisë duhet të ketë njësi të veçantë organizative për kryerjen e atyre punëve.

Neni 150

(1) Rojtari i pronës së fondit pensional vullnetar i bën punët si vijon:

a) i ruan në mënyrë të sigurt të gjitha letrat me vlerë që paraqesin mjete të fondit pensional vullnetar;

b) letrat me vlerë që paraqesin mjete të fondit pensional vullnetar si shkresë elektronike i mban në llogari të veçantë në Depozitarin qendror për letra me vlerë;

c) i ruan dokumentet për barazim në lidhje me arkëtimin e mjeteve financiare të llogarisë bankare dhe pagimin e mjeteve financiare nga llogaria bankare të fondit pensional vullnetar;

ç) punon si ndërmjetësues për barazimin e transaksioneve me letra me vlerë në bazë të urdhëresave të shoqërisë i grumbullon dhe i paguan të ardhurat nga dividendat, kamatat dhe të gjithë të ardhurat tjera që dalin nga depozitet e mjeteve të fondit pensional vullnetar;

d) siguron se marrëveshjet në lidhje me fitimin, investimin dhe bartjen e mjeteve të fondit pensional vullnetar janë në pajtim me këtë ligj, me statutin e fondit pensional vullnetar dhe me urdhëresat që dalin nga transaksionet e shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale dhe se ato urdhëresa janë në pajtim me këtë ligj;

dh) bashkëpunon dhe kryen mbikëqyrje të sub-rojtarit të pronës;

e) llogarit dhe paguan tatime lidhur me investimet dhe dorëzon kërkesë për kthimin dhe lirim nga tatimi; dhe

ë) njofton për kuvendet vjetore të aksionarëve të shoqërive dhe për të drejtat lidhur me pronësinë dhe i realizon urdhëresat lidhur me realizimin e të drejtave të pronësisë.

(2) Të gjitha kompensimet e rojtarit të pronës i paguan shoqëria nga mjetet personale.

Neni 151

(1) Rojtari i pronës është i detyruar që menjëherë, fillimisht me gojë, e më pas edhe me shkrim, ta informojë Agjencinë në rast të dyshimit ose për mosrespektimin e marrëveshjes për ruajtjen e pasurisë në të cilën ai është palë kontraktuese, këtij ligji ose për veprim në kundërshtim me interesat e anëtarëve të fondit pensional vullnetar.

(2) Obligimi nga paragrafi (1) i këtij neni në mënyrë të barabartë ka të bëjë me gjërat e paligjshme ose me veprime tjera të kryera nga ana e shoqërisë dhe personi tjetër.

(3) Rojtari i pronës i paraqet raport Agjencisë në lidhje me aktivitetet e tija çdo 180 ditë ose në periudha më të shkurta kohore. Agjencia së afërmi i përcakton periudhën, formën, si dhe llojin e të dhënave që duhet të jenë të përfshira në raportet.

Neni 152

(1) Shoqëria dhe rojtari i pronës detyrimisht duhet të kenë vazhdimisht marrëveshje për ruajtjen e pronës. Kjo marrëveshje detyrimisht përmban:

a) funksionet konkrete, obligimet dhe detyrat e rojtarit të pronës duke përfshirë edhe përgjegjësinë e tij për evidencën dhe barazimin;

b) shkallën e përgjegjësisë për sub-rojtarin e pasurisë, dhe

c) të gjitha kompensimet që i paguan rojtari i pasurisë.

(2) Zgjedhja e rojtarit të pronës dhe marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni i nënshtrohen pëlqimit paraprak me shkrim të Agjencisë.

Neni 153

(1) Me marrëveshje nuk mund të kufizohet përgjegjësia ligjore e rojtarit të pronës dhe dispozitat e tilla në marrëveshje për ruajtjen e pronës janë të pavlefshme.

(2) Rojtari i pronës përgjigjet për dëmet e paraqitura për shkak të moskryerjes, të kryerjes pa ndërgjegjeje dhe jo në rregull të detyrave dhe të njëjtat nuk mund të mbulohen nga mjetet e fondit pensional vullnetar.

(3) Rojtari i pasurisë nuk mund ta bartë përgjegjësinë e vet në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni dhe në rast kur ka bërë bartjen e disa detyrave sub-rojtarit të pronës në pajtim me nenin 148 paragrafi (2) nga ky ligj.

(4) Në rast kur rojtari i pronës është banka dhe ajo ose me atë persona të lidhur janë aksionarë në shoqëri tjetër, banka është e detyruar të ndërmarrë masa për sigurimin e besueshmërisë së plotë të të dhënave.

Neni 154

(1) Afati i anulimit për prishjen e marrëveshjes për ruajtjen e pronës nuk mund të jetë më i shkurtër se 180 ditë, përveç në rastet e theksuara në nenin 155 të këtij ligji. Pala në marrëveshje e cila dëshiron ta prishë marrëveshjen është e detyruar t'i dorëzojë njoftim me shkrim palës së dytë dhe për atë menjëherë ta informojë Agjencinë, duke i theksuar edhe shkaqet për prishjen e marrëveshjes.

(2) Përzgjedhja e rojtarit tjetër të pronës bëhet kryesisht me pëlqim paraprak me shkrim të Agjencisë, në bazë të kërkesës së arsyetuar me të dhënat e duhura për rojtarin e propozuar të pronës të cilën Agjencisë ia dorëzon Shoqëria.

Neni 155

(1) Në rast se rojtarit të pronës i merret pëlqimi për kryerjen e aktivitetit rojtar i pronës nga ana e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për shkak të moskryerjes, ose kryerjes jo të drejtë ose pa ndërgjegjeje të obligimeve të marrëveshjes për ruajtjen e pronës ose në rastet e falimentimit ose likuidimit ndaj rojtarit të pronës:

a) shoqëria është e detyruar që menjëherë t'i informojë rojtarin e pronës dhe Agjencinë se e prish marrëveshjen për ruajtjen e pronës;

b) shoqëria është e detyruar që menjëherë të zgjedhë rojtar të ri të pronës dhe të marrë pëlqim me shkrim për atë prej Agjencisë, dhe

c) nëse shoqëria nuk vepron në pajtim me pikat a) dhe b) nga ky paragraf, Agjencia me aktvendim mund të japë urdhëresë për ndërrimin e rojtarit ose të caktojë rojtar të ri të pronës.

(2) Agjencia mund t'i urdhërojë shoqërisë ndërrimin e rojtarit të pronës dhe në rast kur struktura e tij financiare ose organizative dukshëm është keqësuar dhe paraqet rrezikim potencial për sigurinë e mjeteve që ruhen te ai rojtar i pronës, si dhe për shkak të moskryerjes, kryerjes jo të drejtë ose pa ndërgjegjeje të obligimeve nga marrëveshja për ruajtjen e pronës:

a) shoqëria është e detyruar që menjëherë që ta informojë rojtarin e pronës se e prish marrëveshjen për ruajtjen e pronës;

b) shoqëria është e detyruar që menjëherë të zgjedhë rojtar të ri të pasurisë dhe të marrë pëlqim me shkrim për atë prej Agjencisë, dhe

c) nëse shoqëria nuk vepron në pajtim me pikat a) dhe b) nga ky paragraf, Agjencia me aktvendim mund të japë urdhëresë për ndërrimin e rojtarit ose të caktojë rojtar të ri të pronës.

(3) Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë ose institucioni tjetër kompetent është e detyruar që menjëherë ta informojë Agjencinë për keqësimet e strukturës financiare dhe organizative të bankës që bën punën e ruajtjes së pronës, për të cilën ka njohuri dhe konsideron se ajo do të mund t'i rrezikojë interesat e anëtarëve të fondit pensional vullnetar. Vëllimin, përmbajtjen dhe formën e njoftimit në detale midis vete i përcakton Agjencia me Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë dhe me institucione tjera kompetente.

Neni 156

(1) Çdo ndryshim i rojtarit të pronës bëhet në mënyrë që do të sigurojë kryerjen e papenguar të shërbimeve të ruajtjes së mjeteve të fondit pensional vullnetar.

(2) Në rast të prishjes së marrëveshjes për ruajtjen e pasurisë, rojtari i pronës është i detyruar t'i dorëzojë mjetet që i janë dhënë për ruajtje, evidencën dhe dokumentacionin e përgjithshëm në lidhje me kryerjen e obligimeve në pajtim me nenin 150 të këtij ligji, rojtarit të ri të pronës, në afat të cilin do ta arrijnë palët në marrëveshje por jo më vonë se 30 ditë pune pas lidhjes së marrëveshjes midis rojtarit të ri të pronës dhe shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare.

Neni 157

Mbi mjetet e fondit pensional vullnetar, të depozituara në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nuk guxon të realizohet përmbarimi i procedurës kundër rojtarit të pasurisë, ato mjete nuk paraqesin pjesë të mjeteve të rojtarit të pronës kundër të cilit është hapur procedurë e falimentimit ose likuidimit dhe nuk guxojnë të jenë lëndë e çfarëdo barazimi.

KREU 16 TË TATUARIT

Neni 158

(1) Siguruesi lirohet nga pagesa e tatimit personal mbi të ardhurat të llogaritur ndaj kontributeve të të punësuarve të vet ose anëtarëve, të arkëtuar në fondin pensional vullnetar. Shuma e lirimit për një vit kalendarik nuk mund të jetë më e madhe se 6 neto rroga mesatare mujore në Republikën e Maqedonisë, të shpallura për vitin e kaluar për të punësuar ose për anëtarë.

(2) Anëtari i fondit pensional vullnetar i cili arkëton mjete personale në fondin pensional, ka të drejtën e kthimit të tatimit personal mbi të ardhurat të llogaritur në shumën e kontributit në Fondin pensional vullnetar. Shuma së cilës i llogaritet kthimi për një vit kalendarik nuk mund të jetë më e madhe se 6 neto rroga mesatare mujore në Republikën e Maqedonisë, të shpallura për vitin e kaluar.

(3) Anëtari i fondit pensional vullnetar për mjetet e arkëtuara në llogarinë e tij individuale nga personi fizik, ka të drejtën e kthimit të tatimit personal mbi të ardhurat të llogaritur në shumën e kontributit në Fondin pensional vullnetar. Shuma së cilës i llogaritet kthimi për një vit kalendarik nuk mund të jetë më e madhe se 6 neto rroga mesatare mujore në Republikë, të shpallura për vitin e kaluar.

(4) Kthimi i tatimit personal mbi të ardhurat e anëtarëve nga paragrafi (2) dhe (3) nga ky nen bëhet në nivel vjetor direkt në llogarinë individuale vullnetare të anëtarit të fondit pensional, me dorëzimin e kërkesës për kthimin e tatimit nga ana e anëtarit ose personit fizik në llogari të anëtarit.

(5) Agjencia së afërmi e përcakton mënyrën e kryerjes së kthimit të tatimit në llogarinë individuale anëtarit të fondit pensional vullnetar, si dhe formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (4) nga ky nen, me mendim paraprak të Ministrisë së Financave.

Neni 159

(1) Të ardhurat e investimit të mjeteve të fondit pensional vullnetar nuk tatohen.

(2) Të ardhurat nga investimi i mjeteve të fondit pensional vullnetar, të sistemuara në llogari vullnetare dhe profesionale të anëtarëve nuk tatohen.

Neni 160

Shërbimet e sigurimit pensional vullnetar me financim kapital janë të liruara nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

KREU 17

DISPOZITAT NDËSHKUESE DHE PËR KUNDËRVAJTJE

a) VEPRAT PENALE

Neni 161

(1) Personi përgjegjës në shoqërinë për menaxhim me fondin pensional i cili me paraqitjen e rrejshme ose me fshehjen e fakteve, me sjelljen në huti ose në mënyrë tjetër joligjore vepron që të merret vendim në shoqërinë për shfrytëzim joligjor ose investim të mjeteve nga fondi pensional vullnetar, dhe për shkak të asaj do të shkaktohet dëmi mbi mjetet e fondit pensional vullnetar, do të dënohet me dënim me burg prej një deri pesë në vjet.

(2) Nëse për shkak të veprës nga paragrafi (1) të këtij neni, është shkaktuar dëmi mbi mjetet e fondit pensional me përmasa të mëdha, kryerësi do të dënohet me burg prej një deri dhjetë vjet.

Neni 162

(1) Personi përgjegjës në rojtarin e pronës që me moskryerjen ose me kryerjen jo të drejtë të obligimeve të tij ligjore të lidhura me ruajtjen e sigurt të letrave me vlerë që paraqesin mjete të fondit pensional vullnetar, shkakton dëm të atyre mjeteve, do të dënohet me dënim me para ose me dënim me burg deri tre vjet.

(2) Me dënimin nga paragrafi (1) të këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në rojtarin e pronës që do të lejojë realizimin e marrëveshjes për fitim investues ose bartjen e mjeteve të fondit pensional vullnetar për të cilën ka pasur njohuri se është joligjore, dhe për shkak të asaj do të shkaktohet dëmi mbi ato mjete.

(3) Nëse për shkak të veprës nga paragrafi (1) të këtij neni, është shkaktuar dëmi mbi mjetet e fondit pensional vullnetar me përmasa të mëdha, kryerësi do të dënohet me burg prej një deri pesë vjet.

Neni 163

Personi përgjegjës në shoqëri për menaxhim me fondet pensionale vullnetare ose personi tjetër juridik që bën punë lidhur me sigurimin pensional vullnetar me financim kapital, që me tejkalimin ose moskryerje të autorizimeve të veta do të cenojë, merr ose kufizojë të drejtën e anëtarit të fondit pensional vullnetar që i takon sipas ligjit, do të dënohet me dënim me para ose me dënim me burg deri tre vjet.

b) DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 164

Barazimi dhe Komisioni për vendosje ndaj kundërvajtjes

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 165, 166, 167, 168, 169, 170 dhe 171 të këtij ligji procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton Komisioni për vendosje ndaj kundërvajtjes i Agjencisë për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital i themeluar në pajtim me Ligjin për sigurim pensional me financim të detyruar kapital.

(2) Dispozitat nga Ligji për Sigurim pensional me financim të detyruar kapital që kanë të bëjnë me barazimin dhe Komisionin për vendosje ndaj kundërvajtjeve do të zbatohen gjatë procedurave në lidhje me kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 165

(1) Gjobë në shumë prej 40 000 deri 50 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale vullnetare ose shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare të detyrueshëm nëse:

1) themelon më shumë se një fond pensional vullnetar, në kundërshtim me nenin 12, paragrafi (1) nga ky ligj;

2) nuk e paguan kapitalin në mënyrë të përcaktuar me nenin 21 nga ky ligj;

3) kapitali themelues rrjedh nga burime që nuk i lejon neni 22 i këtij ligji;

4) nuk bën harmonizim adekuat të aktiviteteve në afat prej 180 ditësh nga ndryshimi i marrëdhënieve organizative në pajtim me nenin 24 të këtij ligji;

5) nuk kërkon pëlqim për secilin fitim ose bartje të aksioneve në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) të këtij ligji;

6) mjetet nga llogaria e anëtarit të fondit pensional vullnetar i jep peng, në asignacion ose i bartë në dobi të personave të tretë në kundërshtim me nenin 101 paragrafi (3) nga ky ligj;

7) paguan kompensim në mënyrë dhe në shumë që nuk janë përcaktuar në nenin 117 dhe 118 të këtij ligji;

8) nuk siguron konkurrencë të plotë provizioneve në pajtim me nenin 120 nga ky ligj;

9) kompenson shpenzime në kundërshtim me nenin 121 nga ky ligj;

10) nuk i sistemon kontributet, mjetet e bartura dhe fitimin në investimet e llogarive individuale të anëtarëve të fondeve pensionale vullnetare dhe nuk mban evidencë në pajtim me nenin 122 të këtij ligji;

11) nuk i shndërron mjetet e fitimit dhe mjetet e bartura në njësi kontabiliteti në pajtim me nenin 123 të këtij ligji;

12) bën vlerësimin e mjeteve të fondit pensional vullnetar, në kundërshtim me dispozitat e nenit 124 të këtij ligj;

13) nuk bën llogaritjen e neto mjeteve të Fondit dhe të vlerës së njësisë së kontabilitetit të secilës datë të vlerësimit dhe nuk e ndryshon vlerën e llogaritur të letrës së caktuar me vlerë, në pajtim me nenin 126 nga ky ligj;

14) e mban kontabilitetin e shoqërisë dhe të Fondit pensional vullnetar të Republikës së Maqedonisë dhe të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në kuptim të nenit 129 të këtij ligji;

15) investon mjetet e Fondit pensional vullnetar në kundërshtim me principet, qëllimet dhe instrumentet e përcaktuara në nenin 130, 131 dhe 134 të këtij ligji;

16) shet, blen ose shfrytëzon mjete në kundërshtim me kufizimet nga neni 136 të këtij ligji;

17) e bart menaxhimin e mjeteve të fond pensional vullnetar, në kundërshtim me nenin 138, paragrafi (1) dhe (2) nga ky ligj;

18) obligohet në kundërshtim me qëllimet dhe kufizimet nga neni 141 të këtij ligji;

19) nuk zgjedh rojtar të pronës të cilit do t'ia besojë përgjegjësinë për ruajtjen e mjeteve të fondit pensional vullnetar ose nuk ka vazhdimisht marrëveshje me rojtarin e pasurisë në pajtim me nenin 148 paragrafi (1) dhe (2) dhe 152 nga ky ligj;

20) zgjedh rojtar të pronës i cili nuk i plotëson kushtet nga neni 149 nga ky ligj;

21) nuk i plotëson obligimet e përcaktuara në nenin 155 paragrafi (1) pikat a) dhe b) dhe (2) nga ky ligj; dhe

22) nuk siguron kryerjen e papenguar të shërbimeve për ruajtjen e mjeteve të Fondit pensional në pajtim me nenin 156 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Gjobë deri në shumën e dhjetëfishuar nga paragrafi (1) nga ky nen do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me Fondet pensionale vullnetare ose shoqërisë për menaxhim me Fondet pensionale të detyrueshme ose vullnetare nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) nga ky nen ka siguruar interes material më të lartë ose i ka shkaktuar dëm më të madh pasurie Fondit pensional vullnetar.

(3) Gjobë në shumën e paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet vetëm shoqërisë për menaxhim me Fondet pensionale vullnetare nëse:

1) bën veprimtari që nuk janë përcaktuar në nenin 16 paragrafi (1) të këtij ligji;

2) nuk e zmadhon kapitalin aksionar në pajtim me nenin 19, paragrafi (2) nga ky ligj;

3) nuk e mban dhe nuk e zmadhon kapitalin aksionar të llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar nga Agjencia dhe nuk mban mjete likuide në shumë jo më të vogël se përqindja e kapitalit themelues në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji;

4) menaxhon me Fondin pensional të detyrueshëm pa lejet e Agjencisë nga neni 67 paragrafi (1) i këtij ligji; dhe

5) paraqet kërkesë për pëlqim për leje për kryerjen e veprimtarisë-menaxhim me Fonde pensionale të detyrueshme dhe në dokumentacionin e dorëzuar ofron të dhëna jo të sakta në kundërshtim me nenin 67 paragrafi (2) i këtij ligji.

(4) Gjobë deri në shumën e dhjetëfishuar nga paragrafi (1) nga ky nen do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me Fondet pensionale vullnetare nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) nga ky nen ka siguruar interes pasurie më të lartë ose i ka shkaktuar dëm më të madh pasurisë së Fondit pensional vullnetar.

(5) Gjobë në shumën e paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet vetëm shoqërisë për menaxhim me Fondet pensionale të detyrueshëm dhe vullnetar nëse:

1) bën veprimtari që nuk janë përcaktuar në nenin 16 paragrafi (2) të këtij ligji;

2) nuk e zmadhon kapitalin aksionar në pajtim me nenin 20, paragrafi (2) nga ky ligj; dhe

3) nuk e mban dhe nuk e zmadhon kapitalin aksionar të llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar nga Agjencia dhe nuk mban mjete likuide në shumë jo më të vogël se përqindja e kapitalit themelues në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) dhe (4) të këtij ligji.

(6) Gjobë deri në shumën e dhjetëfishuar nga paragrafi (1) nga ky nen do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me Fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) nga ky nen ka siguruar interes pasurie më të lartë ose i ka shkaktuar dëm më të madh pasurisë së Fondit pensional vullnetar.

(7) Gjobë në shumën e paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet vetëm shoqërisë për menaxhim me Fondet pensionale vullnetare nëse:

1) menaxhon me Fondin pensional vullnetar pa lejet e Agjencisë nga neni 61 paragrafi (1) i këtij ligji; dhe

2) paraqet kërkesë për leje për kryerjen e veprimtarisë- menaxhim me Fonde pensionale vullnetare dhe në dokumentacionin e dorëzuar ofron të dhëna jo të sakta në kundërshtim me nenin 61 paragrafi (2) i këtij ligji.

(8) Gjobë deri në shumën e dhjetëfishuar nga paragrafi (1) nga ky nen do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me Fondet pensionale të detyrueshëm nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) nga ky nen ka siguruar interes pasurie më të lartë ose i ka shkaktuar dëm më të madh pasurisë së Fondit pensional vullnetar.

(9) Gjobë në shumë prej 4.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës në shoqëri për menaxhim me fonde pensionale vullnetare ose në shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshëm dhe vullnetar, për kundërvajtjen nga paragrafi (3) të këtij neni personit përgjegjës në shoqëri për menaxhim me fondet pensionale vullnetare, për kundërvajtjen nga paragrafi (5) të këtij neni personit përgjegjës në shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, për kundërvajtjen nga paragrafi (7) të këtij neni personit përgjegjës në shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshëm.

(10) Gjobë në shumën e dyfishtë nga paragrafi (9) të këtij neni do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqëri nga paragrafi (9) të këtij neni nëse kundërvajtjen e ka kryer me interes material.

Neni 166

(1) Gjobë në shumë prej 20 000 deri 30 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale vullnetare ose shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare të detyrueshëm në qoftë se:

- 1) i shfrytëzon mjetet e veta për destinime të ndaluara me nenin 32 të këtij ligji;
 - 2) nuk i plotëson kërkesat e përcaktuar në nenin 33 nga ky ligj;
 - 3) nuk themelon njësi organizative për revizion të brendshëm në pajtim me nenin 34 nga ky ligj;
 - 4) nuk emëron revizor të jashtëm të autorizuar me referenca të mira dhe nuk publikon kopje nga raporti financiar i reviduar me konkluzion të revizorit të autorizuar në pajtim me nenin 35 të këtij ligji;
 - 5) nuk vendos llogari individuale në pajtim me nenin 95, paragrafi (1) nga ky ligj;
 - 6) nuk i bart mjetet nga fondi ekzistues në fondin e ardhshëm pensional në pajtim me nenin 97 paragrafi (1) të këtij ligji;
 - 7) jep ose boton informata të gabuara për fondin, që mund t'i sjellin në huti anëtarët ekzistues ose ato të ardhshëm të fondit ose jep deklarata ose supozime për rezultatet e ardhshme investuese për fondin pensional, si dhe nuk dorëzon për pëlqim në Agjenci ose publikon material të pa lejuar për marketing dhe nuk vepron sipas aktvendimit të Agjencisë në kuptim të nenit 107 paragrafi (1), (2), (4) dhe (5) të këtij ligji;
 - 8) zbaton procedura të marketingut të fondeve pensionale të ndaluara në pajtim me nenin 112 të këtij ligji;
 - 9) nuk e plotëson obligimin për informim të rregullt të anëtarëve të fondit pensional vullnetar në pajtim me nenin 114 të këtij ligji;
 - 10) nuk i dorëzon informata dhe të dhëna Agjencisë ose dorëzon informata të gabuara dhe të dhëna në pajtim me nenin 116 të këtij ligji;
 - 11) nuk i informon Agjencinë dhe të gjithë anëtarët e fondit pensional për secilin ndryshim të lartësisë së kompensimeve, në mënyrë dhe në afate të përcaktuara në nenin 119 të këtij ligji;
 - 12) nuk e përcakton fitimin për fondin pensional me të cilin menaxhon në pajtim me nenin 127 të këtij ligji;
 - 13) investon mjete nga Fondi pensional vullnetar në kundërshtim me kufizimet e përcaktuara në nenin 132 dhe 133 të këtij ligji;
 - 14) nuk e informon Agjencinë kur dëshiron ta refuzojë marrëveshjen për ruajtjen e pronës në pajtim me nenin 154 paragrafi (1) të këtij ligji; dhe
 - 15) nuk vepron në pajtim me qëndrimin dhe konkluzionet e paraqitura në aktet e Agjencisë.
- (2) Gjobë deri në shumën e pesëfishuar nga paragrafi (1) nga ky nen do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me Fondet pensionale nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) nga ky nen ka siguruar interes pasurie më të lartë ose i ka shkaktuar dëm më të madh pasurisë së Fondin pensional.

(3) Gjobë në shumë prej 2 000 deri 3 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës në shoqëri për menaxhim me fonde pensionale.

(4) Gjobë në shumë e dyfishtë nga paragrafi (3) të këtij neni do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqëri për menaxhim me fonde pensionale nëse kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni e ka kryer me interes material.

Neni 167

(1) Gjobë në shumë prej 9 000 deri 10 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale vullnetare ose shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare ose të detyrueshëm nëse:

1) refuzon anëtarësimin e personit që i plotëson kushtet të përcaktuara me nenin 94 paragrafi (1) nga ky ligj;

2) nuk i siguron të drejtat e anëtarëve të fondit pensional që ka pushuar që të arkëtojë kontribute në fondin para pensionimit në pajtim me nenin 99 të këtij ligji;

3) bën marketing të fondit pensional personit në lokalet e tij të punës, në kundërshtim me nenin 108, paragrafi (1) nga ky ligj;

4) lidh marrëveshje për anëtarësim me person fizik pa ndërmjetësimin e agjentit në kundërshtim me nenin 109, paragrafi (1) të këtij ligj;

5) nuk i respekton kërkesat në lidhje me publikimin e prospektit informativ të përmbajtur në nenin 113 paragrafi (1), (2), (3) dhe (4) nga ky ligj; dhe

6) nuk i mundëson shikim në prospektin informativ dhe në statutin e fondit të vet secilit person që do të paraqitet për anëtarësim në atë fond ose anëtarit të vet në kundërshtim me nenin 113 paragrafi (5) dhe (6) të këtij ligji.

(2) Gjobë deri në shumë e pesëfishuar nga paragrafi (1) nga ky nen do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me Fondet pensionale nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) nga ky nen ka siguruar interes pasurie më të lartë ose i ka shkaktuar dëm më të madh pronës së Fondit pensional vullnetar.

(3) Gjobë në shumë prej 1.500 deri 2.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës në shoqëri për menaxhim me fonde pensionale.

(4) Gjobë në shumë e dyfishtë nga paragrafi (3) të këtij neni do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqëri për menaxhim me fonde pensionale nëse kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni e ka kryer me interes material.

Neni 168

(1) Gjobë në shumë prej 40000 deri 50.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje rojtarit të pronës nëse:

1) nuk e bën ruajtjen e mjeteve, punën në lidhje me ato mjete dhe evidencën e fondeve pensionale veç e veç për secilin fond pensional, ndaras nga komitentët tjerë dhe të ndarë nga mjete e veta, punën dhe evidencën në pajtim me nenin 148 paragrafi (4) të këtij ligji;

2) nuk i plotëson kushtet e përcaktuara nga neni 149 të këtij ligji;

3) nuk i bën punët nga neni 150 të këtij ligji;

4) nuk e informon menjëherë Agjencinë në rast të mosrespektimit të marrëveshjes për ruajtjen e pronës, ligjit ose për veprimet në kundërshtim me interesat e anëtarëve të fondit pensional, të bërë nga shoqëria ose të cilit do qoftë person tjetër në pajtim me nenin 151 të këtij ligji;

5) i mbulon dëmet nga mjetet e fondit pensional vullnetar, në kundërshtim me nenin 153, paragrafi (2) nga ky ligj;

6) nuk siguron besueshmëri të plotë të të dhënave në pajtim me nenin 153 paragrafi (4) nga ky ligj;

7) nuk e informon Agjencinë kur dëshiron ta refuzojë marrëveshjen për ruajtjen e pasurisë në pajtim me nenin 154 paragrafi (1) të këtij ligji; dhe

8) në rast të prishjes së marrëveshjes për ruajtjen e pasurisë, nuk i plotëson obligimet nga neni 156 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë deri në shumën e dhjetëfishuar nga paragrafi (1) nga ky nen do t'i shqiptohet rojtarit të pasurisë nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) nga ky nen ka siguruar interes pasurie më të lartë ose ka shkaktuar dëm më të madh të pasurisë.

(3) Gjobë në shumë prej 4 000 deri 5 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës në rojtarin e pronës.

(4) Gjobë në shumën e dyfishtë nga paragrafi (3) të këtij neni do t'i shqiptohet personit përgjegjës në rojtarin e pronës nëse kundërvajtja nga paragrafi (1) të këtij neni e ka kryer me interes material.

Neni 169

Gjobë në shumë prej 1 500 deri 2 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje agjentit të shoqërisë nëse:

1) nuk i respekton obligimet dhe përkufizimet e përcaktuara në nenin 109 paragrafi (2), (4) dhe (5) të këtij ligji; dhe

2) realizon kontakte në kundërshtim me nenin 110 nga ky ligj.

Neni 170

Gjobë në shumë prej 500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik nëse:

1) ka më shumë se një llogari vullnetare individuale ose më shumë se një llogari profesionale, në kundërshtim me nenin 95 paragrafi (2) të këtij ligji; dhe

2) nuk i respekton obligimet dhe përkufizimet e përcaktuara në nenin 109 paragrafi (3) dhe (6) të këtij ligji.

Neni 171

(1) Gjobë në shumë prej 5000 deri 7000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që është sigurues i skemës profesionale të pensionit nëse:

1) nuk i siguron informatat e përcaktuara në nenin 85 paragrafi (3) dhe 88 paragrafi (1) nga ky ligj;

2) organizon më shumë skema profesionale pensionale, në kundërshtim me nenin 87 nga ky ligj;

3) nuk i bart kompensimet e anëtarëve të fondit pensional që marrin pjesë në skemën e tij profesionale, në pajtim me nenin 89 të këtij ligji; dhe

4) e bën zgjedhjen në kundërshtim me interesat e pjesëmarrësve në skemën e tij profesionale të pensionit ose implementon mekanizëm për kufizim të të drejtave të pjesëmarrësve në skemën e tij profesionale të pensionit në kundërshtim me nenin 90 të këtij ligji.

(2) Gjobë deri në shumën e pesëfishuar nga paragrafi (1) nga ky nen do t'i shqiptohet personit juridik që është sigurues i skemës profesionale të pensionit nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) nga ky nen ka siguruar interes pasurie më të lartë ose i ka shkaktuar dëm më të madh të pasurisë për pjesëmarrësit e skemës profesionale pensionale.

(3) Gjobë në shumë prej 1 500 deri 2 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës në siguruesin.

(4) Gjobë në shumën e dyfishtë nga paragrafi (3) të këtij neni do t'i shqiptohet personit përgjegjës në siguruesin nëse kundërvajtja nga paragrafi (1) të këtij neni e ka kryer me interes material.

Neni 172

(1) Gjobë në shumë prej 20000 deri 30000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që është paraqitur për leje për themelimin e shoqërisë dhe në dokumentacionin e paraqitur ka ofruar të dhëna jo të sakta në kundërshtim me nenin 30 dhe 55 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 2 000 deri 3 000 euro me kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Organ kompetent për shqiptimin e sanksionit kundërvajtës nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni është gjyqi kompetent.

KREU 18
DISPOZITAT KALIMTARE DHE
PËRFUNDIMTARE

Neni 173

Agjentët e shoqërisë për menaxhim me fondin pensional të detyrueshëm që para hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet të japin provim plotësues për sigurim pensional vullnetar me kapital financiar dhe të reregjistrohen në Regjistrin e agjentëve nëse ajo shoqëri themelon edhe fond pensional vullnetar.

Neni 174

(1) Kërkesat nga neni 54 paragrafi (1), 61 paragrafi (2) dhe 67 paragrafi (2) të këtij ligji paraqiten nga data e përcaktuar e Agjencisë, për çka pëlqim jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(2) Agjencia përcakton një datë për të gjitha shoqëritë para të cilës nuk mund të ndërmerren aktivitete të marketingut dhe hulumtimit të mendimit publik për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital,

Neni 175

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 180 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 176

Kundër vendimit të Këshillit drejtues të Agjencisë personat e pakënaqur mund të paraqesin ankesa në Gjykatën administrative të Republikës së Maqedonisë për zgjidhje në shkallë të dytë.

Neni 177

Dispozitat nga neni 102, 103, 104 dhe 105 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga dita e hyrjes së Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

Neni 178

Agjencia mund të implementojë përkufizime të ndryshme në lidhje me investimin nga dita e hyrjes së Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

Neni 179

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".